



Udhëzuesi praktik EASO: Vlerësimi i provave

Seria e Udhëzuesve praktikë EASO

Mars 2015



This Project is funded by the European Union

Ky dokument u botua falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit "Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II". Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

More information on the European Union is available on the Internet (<http://europa.eu>).

Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2015

Print	ISBN 978-92-9485-459-9	doi:10.2847/28047	BZ-02-15-050-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9476-468-3	doi:10.2847/954760	BZ-02-15-050-SQ-N

© European Asylum Support Office (EASO), 2015

Neither EASO nor any person acting on its behalf may be held responsible for the use which may be made of the information contained herein.

Udhëzuesi praktik EASO: Vlerësimi i provave

Seria e Udhëzuesve praktikë EASO

Mars 2015

Ky udhëzues praktik është zhvilluar në përputhje me metodologjinë e Matricës së Kualitetit EASO. EASO dëshiron t'i falënderojë ekspertët nga Shtetet Anëtare të BE-së, si edhe Grupin e Referencës (të përbërë nga Komisioni Evropian, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët dhe Këshilli Evropian për Refugjatët dhe të Dëbuarit) për kontributin e tyre aktiv dhe mbështetjen e ofruar në zhvillimin e këtij udhëzuesi praktik.

Hyrje

Pse është krijuar ky udhëzues praktik? Udhëzuesi praktik EASO “Vlerësimi i provave” është menduar si një listë praktike e kontrollit dhe një dokument udhëzues për zyrtarët e rastit në tërë Bashkimin Evropian, i cili do t’i ndihmojë edhe jashtë punës së tyre të përditshme. Udhëzuesi është hartuar në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore, duke sugjeruar njëkohësisht një qasje praktike dhe të zbatueshme në punën e përditshme të zyrtarëve të rastit. Ai plotëson kërkesën për të inkuorporuar këto standarde në një qasje të përbashkët të implementimit, si edhe në qëllimin e përgjithshëm të Sistemit Evropian të Përbashkët të Azilit (CEAS) për të trajtuar këto raste në të njëjtën mënyrë.

Si lidhet ky udhëzues praktik me mjetet e tjera mbështetëse të EASO-së? Si të gjitha mjetet mbështetëseky të EASO-së, udhëzues praktik për vlerësimin e provave është bazohet në standardet e përbashkëta të CEAS-it. Misioni i EASO-së është të mbështesë shtetet anëtare, ndër të tjera, përmes trajnimeve të përbashkëta, cilësisë së përbashkët dhe informacionit të përbashkët për vendin e origjinës. Ky udhëzues është krijuar në të njëjtin kuadër dhe duhet të shihet si një plotësues për mjetet e tjera të disponueshme. Pajtueshmëria e tij me këto mjete ka qenë një konsideratë parësore, sidomos në lidhje me modulën e trajnimit EASO “Vlerësimi i provave”, i cili është shumë i afërt. Megjithatë, ky udhëzues nuk mund të zëvendësojë, në asnjë mënyrë, nevojën për trajnime bazë në bazë të këtij moduli. Ndërsa moduli ofron njohuri të thella, aftësi dhe trajnim lidhur me qëndrimin e duhur, ky mjet praktik synon rikapitulimin e përmbajtjeve dhe qasjeve konsekuente në një mjet që mbështet punën e përditshme të zyrtarit rastit.

Ky është një udhëzues praktik i zhvilluar në procesin e Matricës së Kualitetit EASO. Ai duhet të shihet në lidhje me udhëzimet praktike të zhvilluara më herët dhe ato që do të zhvillohen më vonë, siç janë, për shembull, Udhëzuesi Praktik për Intervista personale dhe Mjet Praktik për Identifikimin e personave me Nevoja të Veçanta.

Çfarë përmban ky udhëzues praktik? Ky udhëzues promovon vlerësimin e provave, si një qasje të strukturuar në pajtim me programin mësimor të trajnimeve EASO. Kjo qasje duhet të zbatohet në çdo fazë të procesit të vlerësimit të azilit. Ky udhëzues ndahet në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë ka të bëjë me mbledhjen e informacionit, e dyta me vlerësimin e besueshmërisë dhe e treta me vlerësimin e rrezikut. Udhëzuesit fokusohet në vlerësimin e beshueshmërisë. Vlerësimi i rrezikut prezantohet shkurtimisht si tranzicioni në hapin e ardhshëm dhe të fundit, në të cilin shqyrtohet nevoja për mbrojtje ndërkombëtare.

Sy është krijuar ky udhëzues praktik? Udhëzuesi është krijuar nga anë të ekspertëve të Shteteve Anëtare, me mbështetje të EASO-së. Një Grup Reference, duke përfshirë edhe Komisionin Evropian dhe UNHCR, kanë dhënë një kontribut të vlefshëm. Materialet e lehtësuara nga Grupi i Referencës, duke përfshirë “Përtej provave: Vlerësimi i besueshmërisë në Sistemet e Azilit të BE” të UNHCR-së dhe “Vlerësimi i Besueshmërisë në Procedurat e Azilit: Udhëzues shumëdisiplinor trajnimi” të Komitetit hungarez të Helsinkit, janë burime të rëndësishme të informacionit për hartimin e këtij udhëzuesi praktik. Ky udhëzuesi është konsultuar dhe pranuar nga të gjitha Shtetet Anëtare. Ai është produkt i ekspertizës së kombinuar dhe reflekton standardet dhe objektivet e përbashkëta për të siguruar procedura azili me kualitet të lartë.

Kush duhet të përdorë këtë udhëzues praktik? Ky udhëzues ka për qëllim kryesor t’i mbështesë zyrtarët e rastit në punën e tyre të përditshme. Ai konsiderohet i përdorshëm edhe për zyrtarët e rinj të rastit, të cilët mund të përfitojnë nga udhëzime shtesë në këtë aspekt aq të rëndësishëm të punës së tyre, si edhe për zyrtarët e rastit me vjet përvojë, të cilët mund ta përdorin si kujtesë, kur kanë të bëjnë me raste individuale. Për më tepër, ai duhet të shihet si një mjet vetëvlerësimi dhe një mbikëqyrës i cilësisë. Me rregullime të vogla, ai mund të zbatohet si një mjet për vlerësimin e cilësisë dhe mund të jetë me interes për çdo aktor të përfshirë në procedurën e azilit.

Si duhet të përdoret ky udhëzues praktik? Ky udhëzues është dizajnuar të jetë sa më praktik që është e mundur. Ai është strukturuar në tri shtresa të ndërlidhura. E para është një listë kontrolli, me të cilën sigurohet shqyrtimi i menjëhershëm i elementeve të rëndësishme të secilës nga etapat, nga mbledhja e informacionit dhe lidhja e provave me faktet materiale deri në vlerësimin e besueshmërisë dhe rrezikut. Shtresa e dytë ofron udhëzime të shkurtra, të cilat shpjegojnë dhe plotësojnë çdo element në listë. Shtresa e tretë përmban referenca në instrumentet ndërkombëtare, të Bashkimit Evropian dhe kombëtare të përmendura në udhëzues. Shtresat janë të ndërlidhura në mënyrë interaktive përmes hiperlinqeve, të cilat përmirësojnë karakterin praktik të udhëzuesit kur përdoret në formë elektronike. Udhëzues përfshin një shabllon që mund të përdoret në vlerësimin e një rasti konkret.

Si lidhet ky udhëzues praktik me legjislacionin dhe praktikën kombëtare? Ky është një mjet i butë konvergjence, i cili reflekton standardet e përbashkëta dhe lë hapësirë për variante kombëtare në legjislacion, udhëzime dhe praktikë. Çdo autoritet kombëtar mund të inkorporojë pjesë të rëndësishme të legjislacionit të vet dhe udhëzime në hapësirat e caktuara të këtij udhëzuesi, në mënyrë që zyrtarëve të vet të rastit t'u sigurohen udhëzime të tipit “one-stop” (me një ndalje) për vlerësimin e provave.

Udhëzues praktik EASO: Lista e kontrollit për vlerësimin e provave

Hyrje: Rëndësia e vlerësimit të provave

Hapi 1: Mbledhja e informacionit

- Identifikimi i fakteve materiale
 - Lidhni faktet materiale me kushtet nga përkufizimi i refugjatit.
 - Lidhni faktet materiale me kushtet për përkufizimin e personit të pranueshëm për mbrojtje plotësuese.
 - Mos harroni se identifikimi i fakteve materiale është një proces i vazhdueshëm.
- Zbatoni detyrimin e përbashkët të administrimit të provave për t'i mbledhur provat.
 - Verifikoni nëse aplikuesi ka plotësuar detyrimin e tij/saj për të ofruar prova (detyrimi i aplikuesit për të administruar prova).
 - A ka bërë aplikuesi një përpjekje të sigurtë për të ofruar të gjitha deklaratat dhe dokumentacionin në dispozicionin e tij/saj?
 - A janë ofruar të gjitha provat sa më shpejt të jetë e mundur?
 - A ka ofruar aplikuesi një shpjegim të kënaqshëm për mungesën e provave mbështetëse?
 - Përbushni detyrën e zyrtarit të rastit për të hetuar (detyrimi i zyrtarit të rastit për të administruar prova).
 - Informoni aplikuesin për detyrat e tij/saj.
 - Pyetni për të sqaruar atë që është e paqartë.
 - Zgjidhni mospërputhjet e dukshme, mungesën e informacionit të mjaftueshëm dhe çështjet e besueshmërisë.
 - Merrni informacion relevant për vendin e origjinës.
 - Merrni prova të tjera nëse është e aplikueshme.
 - Veproni në mënyrë të duhur me personat me nevoja veçanta procedurale .
 - Nëse është e aplikueshme, kini parasysh rregullat specifike për administrimin e provave (zhvendosja e detyrimit të administrimit të provave):
 - A zbatohet Neni 4 (4) QD (persekutim e kaluar/demtme i rëndë ose kërcënimet të drejtpërdrejta)?
 - A ka mbrojtje në dispozicion në vendin e origjinës?
 - A mund të zbatohet mbrojtja e brendshme (e njohur edhe si Opsioni i zhvendosjes së brendshme)?
 - A mund të zbatohet përjashtimi nga mbrojtja ndërkombëtare?
 - A vjen kërkuesi nga një vend i sigurt të origjinës, ashtu siç përcaktohet në legjislacionin tuaj kombëtar?
- Mblidhni prova relevante për faktet materiale.
 - Merrni deklaratat e kërkuesit.
 - Intervista personale.
 - Deklaratat e shkruara.

- Mblidhni prova nga burime të tjera.
 - Dokumentet (e paraqitura nga kërkuesi).
 - Informacion për vendin e origjinës (COI)
 - Prova të tjera.
 - Raportet e ekspertëve.
 - Raportet mjekësore dhe psikologjike.
 - Raportet për analizën gjuhësore.
 - Informacion nga persona të tjerë (dëshmia e dëshmitarëve).
 - Informacion nga autoritetet të Shtetit Anëtar.
 - Informacion nga shtetet e tjera anëtare.

Hapi 2: Vlerësimi i besueshmërisë

- Lidhni provat me secilin fakt material.
- Vlerësoni deklaratat e kërkuesit në bazë të treguesve të besueshmërisë.
 - Mësoni për besueshmërinë e brendshme.
 - Mjaftueshmëria dhe natyra specifike e detajeve.
 - Përputhshmëria
 - Sjellja nuk duhet të përdoret si tregues i besueshmërisë.
 - Mësoni për besueshmërinë e jashtme.
 - Përputhshmëria me COI.
 - Përputhshmëria me informacion të njohur në përgjithësi.
 - Përputhshmëria me prova të tjera.
 - Bëni konstatime lidhur me mundshmërinë (rendesine).
- Vlerësoni dokumentet.
 - Relevanca
 - Ekzistenca
 - Përmbajtja
 - Forma
 - Natyra
 - Autori
 - Vlerëson provat mjekësore dhe psikologjike
- Kini parasysh faktorët individualë dhe rrethanorë që mund të çojnë në deformime.
 - Faktorët lidhur me kërkuesin
 - Kujtesa
 - Trauma dhe PTSD
 - Probleme të tjera psikologjike dhe shëndetësore
 - Moshë
 - Arsimimi
 - Kultura, feja dhe besimet
 - Orientimi seksual dhe identiteti gjinor (SOGI)
 - Gjinia

- Faktorët lidhur me zyrtarin e rastit
 - Kini parasysh efektin e stresit, ngarkesës së punës dhe afateve.
 - Kini parasysh efektin e ekspozimit afatgjatë në fushën e azili.
 - Parandaloni paragjykimet dhe stereotipet.
 - Rëndësia e vetëvlerësimit dhe e mbikëqyrjes.
- Faktorët lidhur me situatën e intervistës.
- Përcaktoni se cilat fakte materiale do të pranohen.
 - Shikoni të gjitha provat lidhur me çdo fakt material në tërësinë e tij.
 - Përcaktoni se cilat fakte janë të provuara (të pranuar) apo jo (të refuzuara).
 - Përcaktoni se cilat fakte janë akoma të pasigurta.
 - Zbatoni Nenin 4 (5) QD në ato faktet materiale që mbeten të pasigurta (përfitimi nga dyshimi).

Hapi 3: Vlerësimi i rrezikut

- Analizoni frikën e mire bazuar nga nga persekutimi /rrezikun real të demtimeve të rëndë.
 - Zbatoni Nenin 4 (3) QD
 - Kini parasysh nese ka pasur apo jo persekutime dhe demtime serioz në të kaluarën.
 - Zbatoni standardin e provës.

Udhëzuesi praktik EASO: Vlerësimi i provave

Udhëzim

Rëndësia e vlerësimit të provave [prapa]

Vlerësimi i provave mund të perkufizohet si metoda kryesore për përcaktimin e fakteve në një rast individual përmes procesit të shqyrtimit dhe krahasimit të provave të disponueshme.

Në përgjithësi, fusha e vlerësimit të provave nuk rregullohen nga e drejta ndërkombëtare. Konventa e Gjenevës 1951 nuk parashikon asnjë dispozitë të veçantë që ka të bëjë me vlerësimin e provave. Megjithatë, disa udhëzime janë zhvilluar në këtë fushë përmes këtyre dy botimeve të UNHCR-së: “Doracaku dhe udhëzimet për procedurat dhe kriteret për përcaktimin e statusit të refugjatëve sipas Konventës së vitit 1951 dhe Protokollit të vitit 1967 lidhur me Statusin e Refugjatëve” (i ribotuar në 2011), paragrafët 195-205, dhe ‘Shënime mbi detyrimin dhe standardin për administrimin e provave në kërkesat e refugjatëve’ (1998).

Në fushën e vlerësimit të provave, **Direktiva e kualifikimit (QD)** përbën instrumentin e parë ligjorprevalues të detyrueshëm me zbatim rajonal, me të cilin përcaktohet se cilat janë kriteret që kërkuesi duhet të plotësojë për t’u kualifikuar si refugjat ose si një person tjetër që ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. QD mbështetet kryesisht në mjetet dhe jurisprudencën ndërkombëtare dhe evropiane mbi të drejtat e refugjatëve dhe të drejtat e njeriut.


Megjithatë, vendet evropiane kanë tradita ligjore dhe praktika të ndryshme lidhur me vlerësimin e provave në përgjithësi. Nëse Shtetet Anëtare zbatojnë koncepte ligjore të ngjashme lidhur me pranueshmërinë për mbrojtje ndërkombëtare, por vlerësojnë provat në mënyrë të ndryshme, ato mund të arrijnë lehtë në përfundime të ndryshme. Për më tepër, procedurat e azilit janë të ndryshme nga çdo procedurë tjetër ligjore, pjesërisht për shkak të mungesës së mjeteve “të zakonshme” për administrimin e provave në menyre objektive, si edhe për shkak të pasojave të rënda të vendimit. Për këtë arsye, përcaktimi i kërkesave për norma procedurale specifike lidhur me vlerësimin e provave në procedurën e azilit dhe njohja e këtyre standardeve kanë një rëndësi thelbësore për një proces vendimmarrës të drejtë dhe të efektshëm.

Vlerësimi i provave është një metodologji që duhet pasur parasysh gjatë tërë procesit të shqyrtimit të një kërkesë për azil.

Ky udhëzues praktik paraqet një qasje në tre hapa për vlerësimin e provave:

- Hapi 1: Mbledhja e informacionit
- Hapi 2: Vlerësimi i besueshmërisë
- Hapi 3: Vlerësimi i riskut

Zyrtari i rastit zbaton këta hapa gjatë të gjitha etapave të ndryshme të procedurës së azilit:



Hapi 1 Mbledhja e informacionit [prapa]

1.1 Identifikimi i fakteve materiale [prapa]

Për të vlerësuar një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, zyrtari i rastit duhet t'i identifikojë faktet materiale.

Faktet materiale janë ato fakte që janë të lidhura drejtpërdrejt me përkufizimin e refugjatit (Neni 1 (A) (2) i Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Neni 2 (d) QD) ose të personit të pranueshëm për mbrojtje subsidiare (Neni 2(F) dhe Neni 15 QD) dhe kanë të bëjë me thelbin e kërkesës. Zakonisht është e panevojshme të fokusohemi në fakte të vogla ose jo thelbësore që nuk ndikojnë në elementet qendrore të kërkesës.

Identifikimi i pershtatshëm i fakteve materiale është i rëndësishëm për vlerësimin e besueshmërisë dhe rrezikut. Në qoftë se një fakt nuk është material, atëherë nuk ka nevojë për ta marrë parasysh, pavarësisht që pranohet apo jo nga zyrtari. Kur zyrtari i rastit pranon një fakt material, ai ose ajo mund të vlerësojë nevojën për mbrojtje ndërkombëtare në bazë të këtij fakti. Një fakt material që nuk është pranuar gjatë vlerësimit të besueshmërisë nuk do të merret parasysh për vlerësimin e rrezikut. Për informacion të detajuar mbi vlerësimin e besueshmërisë dhe rrezikut, shihni hapat 2 dhe 3.

Shihni modelin për identifikimin e fakteve materiale.

1.1.1 Lidhni faktet materiale me kushtet për përkufizimin e refugjatit [prapa]

Elementet kryesor për përkufizimin e refugjatit janë si vijon:

- Kërkuesi duhet të jetë shtetasi i një vendi të tretë jashtë vendit të tij/saj të origjinës (ose një person pa shtetësi jashtë vendit të tij/saj të banimit të përhershëm);
- Kërkuesi duhet të ketë frikë të justifikuar nga përndjekja;
- Frika e përndjekjes duhet të jetë e lidhur (apo të perceptohet si e lidhur) me racën, fenë, kombësinë, mendimin politik ose anëtarësinë e kërkuesit në një grup social të caktuar.
- Kërkuesi duhet ta ketë pamundur ose, për shkak të frikës së justifikuar, të mos dëshirojë të përfitojë nga mbrojtja e vendit të origjinës;
- Kërkuesi nuk duhet të përjashtohet nga statusi i refugjatit.

1.1.2 Lidhni faktet materiale me kushtet nga përkufizimi i personit të pranueshëm për mbrojtje subsidiare. [prapa]

Kushtet nën të cilat një person është i pranueshëm për mbrojtje subsidiare jepen më poshtë:

- Kërkuesi duhet të jetë shtetasi i një vendi të tretë jashtë vendit të tij/saj të origjinës (ose një person pa shtetësi jashtë vendit të tij/saj të banimit të përhershëm);
- Kërkuesi duhet të jetë një person që nuk kualifikohet si refugjat;
- Duhet të ekzistojnë baza të mjaftueshme për të besuar se kërkuesi do të përballë me një rrezik real ose do të vuajë lëndime serioze, ashtu siç përcaktohet në Nenin 15 QD;
- Kërkuesi duhet të mos jetë në mundësi ose, për shkak të këtij rreziku, të mos dëshirojë të përfitojë nga mbrojtja e vendit të origjinës;
- Kërkuesi nuk duhet të përjashtohet nga mbrojtja subsidiare.

1.1.3 Mos harroni se identifikimi i fakteve materiale është një proces i vazhdueshëm [prapa]

Parimi baze është që zyrtari i rastit duhet të jetë mendjehapur dhe të marrë parasysh faktet e reja që mund të dalin gjatë tërë procesit.

Identifikimi i fakteve materiale është një proces i vazhdueshëm, i cili zhvillohet që nga momenti kur kërkuesi paraqet aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare deri në momentin kur zyrtari i rastit fillon vlerësimin e rrezikut.

Zyrtari i rastit identifikon faktet materiale të aplikimit, kur përgatitet për intervistën, në bazë të informacionit të disponueshëm në fillim. Gjete intervistimit të aplikuesit ai/ajo shqyrton dokumentat dhe provat apo deshmitaret si dhe informacioni nga vendi i origjinës. Intervista do të mbahet, pasi zyrtari i rastit ka ekzaminuar dokumentet dhe provat e paraqitura, deklaratat e anëtarëve të familjes ose dëshmitarëve, si edhe informacionin e vendit të origjinës.

(Shihni **shabllonin** për shpjegimin e mënyrës se si identifikohen faktet materiale)

1.2 Zbatoni detyrimin e përbashkët për administrimin e provave për t'i mbledhur provat. [prapa]

Aplikimet për mbrojtjen ndërkombëtare nisin me faktin që aplikuesi ka barrën e provës mbi pretendimin që ngre. Megjithatë, për shkak të karakteristikave të veçanta të procedurës së azilit, çështja e detyrimit të administrimit të provave bëhet më komplekse.

Procesi i mbledhjes së provave me qëllim për të përcaktuar faktet materiale u nënshtrohet tri parimeve kryesore:

- 1) Kërkuesi ka detyrimin të ofrojë prova (detyrimi i kërkuesit për të administruar prova);
- 2) Zyrtari i rastit është në detyrë të hetojë (detyrimi i zyrtarit të rastit për të administruar prova).
- 3) Rregullat specifike për administrimin e provave (zhvendosja e detyrimit për administrimin e provave);

1.2.1 Verifikoni nëse kërkuesi përmbush detyrën e tij/saj për të ofruar prova (detyrimi i kërkuesit për të administruar prova) [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të njoftojë kërkuesin për detyrimin e tij/saj për të ofruar prova. Kjo nënkupton që kërkuesi është në detyrë të japë një deklaratë të besueshme, të paraqesë të gjitha provat në dispozicionin e tij/saj dhe të bashkëpunojë me autoritetet në ekzaminimin e kërkesës së tij/saj.

Në pajtim me **Nenin 4 (1) QD**, Shtetet Anëtare mund të konsiderojnë që kërkuesi është në detyrë të paraqesë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjitha elementet e nevojshme për të mbështetur kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Elementet përbëhen nga deklaratat e kërkuesit dhe të gjitha dokumentet në dispozicion të kërkuesit lidhur me moshën, të shkuarën e aplikuesit si edhe të afërmeve të tij/saj, si edhe me identitetin, shtetësinë/shtetësitë, shtetin/shtetet dhe vendin/vendet e mëparshme të banimit, kërkesat e mëparshme të azilit, itineraret e udhëtimit dhe arsyet për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare (**Neni 4 (2) QD**).

1.2.1.1 A ka bërë kërkuesi një përpjekje të sinqertë për të ofruar të gjitha deklaratat dhe dokumentacionin në dispozicionin e tij/saj? [prapa]

Kërkuesi duhet t'i ofrojë zyrtarit të rastit të gjitha provat relevante në dispozicionin e tij/saj.

Kur vlerësohet sjellja e kërkuesit në këtë aspekt (dmth nga pikëpamja e provave që ai/ajo duhet të ketë ose të ketë mundësinë për t'i marrë), zyrtari i rastit duhet të ketë parasysh të gjitha rrethanat individuale dhe kontekstuale të rastit, siç janë mjetet e disponueshme për të marrë prova, shëndeti fizik/mendor i kërkuesit, niveli i tij/saj arsimor, situata në vendin e origjinës, lidhjet familjare, arsyeja dhe mënyra se si kërkuesi është larguar nga vendi, legjislacioni përkatës i vendit të origjinës etj.

1.2.1.2 A janë ofruar të gjitha provat sa më shpejt të jetë e mundur? [prapa]

Kërkuesi duhet të paraqesë të gjitha provat në dispozicionin e tij/saj sa më shpejt që të jetë e mundur. Në këtë mënyrë, zyrtari i rastit mund të identifikojë dhe të vlerësojë, në kohën dhe mënyrën e duhur, të gjitha faktet materiale të rastit. Plotësimi i këtij detyrimi është i lidhur ngushtë me detyrimin e autoritetit për të informuar kërkuesin lidhur me detyrimet e tij/saj gjatë procedurës së azilit, si edhe me mjetet në dispozicion të kërkuesit me qëllim për të siguruar provat dhe rrethanat individuale dhe kontekstuale të rastit.

Një qasje praktike është të diskutoni me kërkuesin për provat që ai/ajo ka ndërmend të paraqesë dhe të bini dakord mbi një afat kohor të arsyeshëm.

1.2.1.3 A ka ofruar kërkuesi një shpjegim të kënaqshëm për mungesën e provave mbështetëse? [prapa]

Kërkuesi mund të mos jetë në mundësi të paraqesë prova lidhur me disa fakte të rastit. Zyrtari i rastit duhet të vlerësojë nëse janë të pranueshme shpjegimet e kërkuesit lidhur me pamundësinë e tij/saj për të paraqitur prova shtesë. Shpjegimet e ofruara nga kërkuesi duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rrethanat individuale dhe kontekstuale të rastit, në bazë të treguesve të besueshmërisë dhe faktorëve që mund të çojnë në shtrembërimë (shihni gjithashtu 2.4 Faktorët që mund të çojnë në shtrembërimë).

1.2.2 Përmbushni detyrën e zyrtarit të rastit për të hetuar (detyrimi i zyrtarit të rastit për të administruar prova). [prapa]

Kërkuesi duhet të ketë mundësi të paraqesë të gjitha faktet materiale dhe të gjitha provat relevante. Në bashkëpunim me kërkuesin, autoriteti vendimmarrës është në detyrë të përcaktojë elementet relevante të kërkesës. Me qëllim për të përmbushur këtë obligim, zyrtari i rastit duhet:

1.2.2.1 Të informoni kërkuesin për detyrat e tij/saj [prapa]

Kërkuesi duhet të informohet lidhur me detyrimet e tij/saj në procedurën e azilit, duke përfshirë detyrimin për të bashkëpunuar, dhe pasojat në qoftë se nuk do të veprojnë në pajtim me këto detyrime. Informacioni duhet të jepet sa më shpejt të jetë e mundur në përputhje me procedurat kombëtare. Informacioni duhet të jepet në një gjuhë që kërkuesi e kupton ose mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme që e kupton dhe duhet të jetë i lehtë për ta kuptuar. Informacioni i dhënë duhet të përfshijë kornizat kohore të zbatueshme për plotësimin e detyrimeve. Gjithashtu, kërkuesi duhet të marrë informacion praktik lidhur me mjetet për të përmbushur detyrimet e tij/saj në pajtim me legjislacionin dhe praktikën kombëtare.

1.2.2.2 kërkojin për të sqaruar atë që është e paqartë [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të sqarojë të gjitha faktet relevante të kërkesës, në bashkëpunim me kërkuesin, duke marrë parasysh provat e disponueshme, informacionin për vendin e origjinës dhe faktorët e mundshme që mund të shkaktojnë shtrembërimë (shihni gjithashtu 2.4 Faktorët që mund të çojnë në shtrembërimë). Vlerësimi i rastit nuk duhet të bazohet në aspekte që janë të paqarta për zyrtarin e rastit dhe mund të lere vend për supozime, spekulime, hamendesime, intuitës apo instiktin etj.

1.2.2.3 Zgjidhni mospërputhjet e dukshme, mungesën e informacionit të mjaftueshëm dhe çështjet e besueshmërisë. [prapa]

Mospërputhjet, çështjet e besueshmërisë dhe mungesa e informacionit të mjaftueshëm duhet të diskutohen me kërkuesin, i cili duhet të ketë mundësi për t'i sqaruar. Zyrtari i rastit duhet të fokusohet në identifikimin e arsyeve të tyre, në mënyrë që të jetë në mundësi të vlerësojë në mënyrë të duhur ndikimin e tyre në vlerësimin e besueshmërisë. Zyrtari i rastit duhet të marrë parasysh praninë e mundshme të faktorëve shtrembërues (shihni 2.4 Faktorët që mund të çojnë në shtrembërimë), të cilët mund të ndikojnë në përputhshmërinë e deklaratave të kërkuesit dhe aftësinë e tij/saj për të siguruar informacion të detajuar.

1.2.2.4 Merrni informacion relevant për vendin e origjinës [prapa]

Për të vlerësuar rastin, zyrtari i rasti duhet të marrë informacion relevant, të saktë dhe të azhurnuar për vendin e origjinës (COI). COI duhet të jetë aq specifik sa të jetë e mundur dhe të mos të mos kufizohet në situatën e përgjithshme në vendin e origjinës. Ai duhet të vijë nga burime të ndryshme, siç janë njësitë kombëtare COI, EASO, UNHCR dhe organizatat e tjera relevante për të drejtat e njeriut. Informacioni COI duhet të jetë objektiv dhe qasja në mbledhjen e tij duhet të jetë e paanshme (personi që e mbledh nuk duhet të kërkojë COI që do të mbështesë vetëm një vendim negativ apo pozitiv).

1.2.2.5 Merrni prova të tjera nëse është e mundur [prapa]

Për të vlerësuar rastin, zyrtari i rastit mund të jetë në detyrë të marrë edhe prova të tjera *ex officio* (Shihni seksionin 1.3.2.3 Provat e tjera).

1.2.2.6 Veproni në mënyrë të duhur me personat me nevoja procedurale të veçanta [prapa]

Për të mbështetur kërkesat e tyre në mënyrë të efektshme, ka kërkuar që mund të kenë nevojë për garancia procedurale të veçanta, ndër të tjera, për shkak të moshës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, paaftësisë, sëmundjes serioze ose çrregullimeve të tyre mendore, ose si pasojë e torturës, përdhunimit ose formave të rënda të tjera të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale. Shtetet Anëtare do të vlerësojnë brenda një periudhe kohore të arsyeshme pas paraqitjes së kërkesës nëse kërkuar ka nevojë për garanci procedurale të veçanta dhe, kur është rasti, t'i sigurojë mbështetje të përshtatshme.

Duhet të theksohet në mënyrë të veçantë roli hetues i zyrtarit të rastit në rast të personave me nevoja të veçanta procedurale. Zyrtari i rastit duhet të mbledhë informacionin e duhur, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të kërkuarit. Për të vlerësuar, në mënyrë të efektshme, ndikimin e këtyre rrethanave në rast, zyrtari i rastit mund të kërkojë mendimin e ekspertëve (p.sh. në rast të çrregullimeve mendore, pasojave të formave të ndryshme të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale, etj.). Zyrtari i rastit duhet t'i japë kërkuarit me nevoja procedurale të veçanta mjaft kohë që ai/ajo të paraqesë elementet e nevojshme për të mbështetur kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare, duke marrë parasysh këto nevoja edhe atëherë kur mbahet intervista personale.

1.2.3 Nëse është e aplikueshme, kini parasysh rregullat specifike për administrimin e provave (zhvendosja e detyrimit të administrimit të provave) [prapa]

Detyrimi i administrimit të provave zhvendoset ose kalon te zyrtari i rastit, në qoftë se ai/ajo argumenton se vendi i origjinës ofron një alternativë të mbrojtjes së brendshme ose mbrojtje, ose që ka elemente, të cilat sugjerojnë se kërkuar duhet të përjashtohet nga mbrojtja ndërkombëtare. Ky kslim ndodh edhe në qoftë se kërkuar tregon se ai/ajo ka qenë tashmë objekti i përndjekjes ose lëndimit serioz, ose që janë kanosur me persekutim ose lëndimi në vendin e origjinës. Ka edhe raste të tilla, si për shembull atëherë kur zbatohet koncepti i shtetit të sigurt, kur detyrimi i administrimit të provave zhvendoset ose kalon te kërkuar.

1.2.3.1. A zbatohet Neni 4 (4) QD (përndjekja e kaluar/demtimi i rëndë ose kërcënimet të drejtpërdrejta [prapa]

Gjatë shqyrtimit të fakteve, zyrtari i rastit mund të përcaktojë që kërkuar ka provuar që ai/ajo ka qenë tashmë objekti i përndjekjes ose lëndimit serioz, ose që ka qenë objekt kërcënime përndjekjeje ose lëndimi në vendin e origjinës. Kjo do të ishte një tregues serioz i frikës së justifikuar të kërkuarit lidhur me përndjekjen ose rrezikun real e lëndimit serioz, përveç situatës kur ka arsye të mira për të konsideruar që kjo përndjekje ose lëndim serioz nuk do të përsëritet. Zyrtari i rastit është në detyrë të provojë nëse ekzistojnë këto arsye të mira.

1.2.3.2 A ka mbrojtje në dispozicion në vendin e origjinës? [prapa]

Ndërsa kërkuar duhet të provojë kërkesën e vet (rrezikun e përndjekjes/lëndimit serioz në qoftë se do ta kthejnë në vendin e origjinës), detyrimi për të provuar që ka mbrojtje në dispozicion në vendin e origjinës (rrethana e kundërt) i takon zyrtarit të rastit.

Me qëllim për të përcaktuar disponueshmërinë e mbrojtjes në vendin e origjinës, zyrtari i rastit duhet të identifikojë, gjatë procesit të identifikimit të fakteve materiale, nëse kërkuar është përpjekur për të kërkuar mbrojtje nga autoritetet/aktorët relevantë apo jo, pse nuk e ka kërkuar, në qoftë se nuk e ka kërkuar, nga cilat autoritete/aktorë ai/ajo ka kërkuar mbrojtje, cili ka qenë rezultati i këtij veprimi dhe nëse mbrojtja ka qenë e disponueshme, e efektshme dhe e natyrës jo-përkohshme (Neni 7 QD).

1.2.3.3 A mund të zbatohet mbrojtja e brendshme (e njohur edhe si Opsioni i arratisjes së brendshme)? [prapa]

Nëse qoftë se parashikohet nga ligji kombëtar, zyrtari i rastit mund të pohojë se mbrojtja e brendshme kundër përndjekjes ose lëndimit serioz është e efektshme dhe në dispozicion të kërkuarit në një pjesë të vendit të origjinës. Në këtë situatë, zyrtari i rastit duhet të provojë që ekziston një pjesë e vendit të origjinës, ku kërkuar mund të udhëtojë në mënyrë të sigurt dhe ligjore, të hyjë dhe ka gjasa të arsyeshme që do të vendoset (Neni 8 QD).

Për të mbështetur një konstatim të tillë, zyrtari i rastit duhet të ketë parasysh, gjatë identifikimit të fakteve materiale, rrethanat e përgjithshme që mbizotërojnë në atë pjesë të vendit, si edhe rrethanat personale të

kërkuesit. Zyrtari i rastit do të sigurojë që informacion i saktë dhe i azhurnuar për situatën e përgjithshme të vendit dhe situatën e rajonit të mbrojtjes të identifikuar në atë vend merret nga burimet relevante, siç janë UNHCR dhe EASO.

Në qoftë se shteti apo agjentët e shtetit janë aktorët e përndjekjes ose lëndimit serioz, zyrtari i rastit duhet të supozojë që nuk ka mbrojtje të brendshme të efektshme në dispozicion të kërkuesit.

Në qoftë se kërkuesi është një i mitur i pashoqëruar, disponueshmëria e mundësive të kujdestarisë dhe përkujdesjes së përshtatshme në interesin më të mirë të të miturit të pashoqëruar duhet merret parasysh në hetimin që zyrtari i rastit e kryen, si edhe në vendimin lidhur me disponueshmërinë e mbrojtjes së efektshme.

1.2.3.4 A mund të zbatohet përjashtimi nga mbrojtja ndërkombëtare? [prapa]

Në procesin e përcaktimit të fakteve materiale (para provimit faktike), zyrtari i rastit mund të identifikojë arsye, të cilat mund të çojnë në përjashtimin e kërkuesit nga mbrojtja ndërkombëtare.

Nëse zyrtari i rastit konsideron se kërkuesit duhet t'i refuzohet mbrojtja në bazë të përjashtimit, atëherë ai/ajo duhet të provojë këtë në bazë të [Nenit 12 QD](#) dhe [Nenit 17 QD](#).

Përjashtimi duhet të bazohet në prova të qarta dhe të besueshme. Kërkuesit duhet t'i jepet mundësi për të kundërshtuar provat që përdoren për të mbështetur përjashtimin.

1.2.3.5 A vjen kërkuesi nga një vend i sigurt të origjinës, ashtu siç përcaktohet në legjislacionin tuaj kombëtar? [prapa]

Disa Shtete Anëtare kanë pranuar konceptin e vendit të sigurt të origjinës, duke caktuar disa vende si vende të sigurta të origjinës në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar. Në varësi nga legjislacioni dhe praktika kombëtare, nëse kërkuesi vjen nga një vend i tillë, zyrtari i rastit mund supozojë që vendi është i sigurt për kërkuesin, përveç rastit kur kërkuesi paraqet prova që tregojnë të kundërtën. Përcaktimi i një vendi si vend i sigurt nuk mund të përfaqësojë një garanci absolute të sigurisë për secilin shtetas të atij vendi.

Kur një kërkues tregon se ka arsye serioze për të konsideruar që vendi nuk është i sigurt në rrethanat e tij/saj të veçanta, përcaktimi i vendit si vend i sigurt nuk mund të konsiderohet relevante për kërkuesin. Sipas udhëzimeve dhe praktikës kombëtare, zyrtari i rastit duhet t'i japë kërkuesit mundësinë e efektshme për të paraqitur kundërgargumentet, duke përfshirë informimin e përshtatshëm të kërkuesit dhe diskutimin e temës gjatë intervistës personale.

1.3 Mblidhni prova relevante për faktet materiale [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të hetojë dhe të shqyrtojë provat e disponueshme dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojë paraqitjen e provave materiale shtesë që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme (p.sh. raporte nga media, prova mjekësore etj).

Për të siguruar cilësinë e lartë të procesit vendimmarrës, është e domosdoshme që zyrtari i rastit të ndihmojë kërkuesin, duke shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura. Gjithashtu, ai/ajo duhet t'i japë kërkuesit mundësinë për të paraqitur ndonjë provë relevante.

Të gjitha provat duhen mbledhur me qëllim për t'u pajtuar me [Nenin 4 \(3\) QD](#). Zyrtari i rastit duhet të sigurohet që ai/ajo kupton rëndësinë e çdo prove të paraqitur nga kërkuesi në mbështetje të kërkesës.

Ka situata, në të cilat, edhe në qoftë se kërkuesi ka bërë përpjekje të sinqerta për të paraqitur të gjitha deklaratat dhe dokumentet në dispozicion të tij/saj dhe ka ofruar shpjegime të kënaqshme për mosparaqitjen e disa provave, zyrtari i rastit mund të konsiderojë të nevojshme të marrë informacion shtesë me qëllim për të qartësuar të gjitha faktet relevante të rastit. Informacioni shtesë mund të mblidhet nga deklaratat e mëtejshme të kërkuesit dhe anëtarëve të familjes së tij/saj, opinionet e ekspertëve, provat shkresore të reja, informacion më i saktë për vendin e origjinës etj. Legjislacioni dhe udhëzimet kombëtare mund të përfshijnë afate kohore për të mbledhur informacionin shtesë.

Është e pranuar që kërkuesit nuk mund shpesh të provojnë deklaratat e tyre përmes provave dokumentare të pavarura ose provave të tjera. Për shembull, mund të ketë vështirësi logjistike ose të sigurisë, të cilat pengojnë marrjen e dokumenteve zyrtare origjinale nga vendi i origjinës. Megjithatë, çdo informacion i paraqitur mund të ndihmojë shumë zyrтарin e rastit në vlerësimin e besueshmërisë së përgjithshme të kërkesës.

1.3.1. Mblidhni deklaratat e kërkuesit [prapa]

Deklarata personale e kërkuesit është zakonisht prova kryesore dhe nganjëherë e vetmja provë. Këto prova mund të paraqiten në disa mënyra të ndryshme, duke përfshirë intervistën personale, deklaratën me shkrim ose të dyja.

1.3.1.1. Intervista personale [prapa]

Në shumicën e rasteve, intervista personal do të jetë burimi kryesor i provave për zyrтарin e rastit gjatë vlerësimit të kërkesës. Për këtë arsye është e domosdoshme që intervista të kryhet në mënyrë që të sigurohen prova cilësore nga kërkuesi.

Udhëzimet për kryerjen e një interviste cilësore mund të gjenden në **Udhëzuesin Praktik EASO për Intervistat Personale**.

1.3.1.2. Deklaratat me shkrim [prapa]

Ka situata ku deklaratat me shkrim mund të pranohen si prova të mëtejshme në mbështetje të kërkesës. Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me pranueshmërinë e deklaratave me shkrim, klikoni [këtu](#).

1.3.2. Mblidhni prova nga burime të tjera [prapa]

Përveç dëshmisë së vet përveç intervistës personale dhe/ose paraqitjes së një deklaratë me shkrim, kërkuesit mund të ofrojnë prova shtesë në disa forma të ndryshme.

Më poshtë do të gjeni udhëzime për llojet më të zakonshme të provave të paraqitura, si edhe për mënyrën se si ato duhet të trajtohen. Kur mblidhen dëshmi nga burime të tjera, zyrтарi i rastit duhet të ketë kujdes dhe të respektojë rregullat e konfidencialitetit.

1.3.2.1. Dokumentet e paraqitura nga aplikanti [prapa]

Çdo dokument i paraqitura nga kërkuesi, si dëshmi për të mbështetur kërkesën e tij/saj duhet të shqyrtohet tërësisht. Zyrтарi i rastit duhet të sigurohet së pari që është i vetëdijshëm për dokumentet që janë paraqitur dhe rëndësinë e tyre për kërkesën. Nëse është e mundur, zyrтарi i rastit duhet të marrë informacion lidhur me përmbajtjen dhe formën përgjithësisht të pritshme të ndonjërit prej dokumenteve të paraqitura (p.sh. urdhër-arrestet, thirrjet në gjykatë). Një informacion i tillë mund të merret përmes informacionit relevant mbi vendin e origjinës.

Zyrтарi i rastit duhet të jetë i kënaqur edhe me mënyrën se si kërkuesi ka siguruar dokumentet që i ka dorëzuar. Nëse kërkues ka paraqitur një dokument që nuk mund të sigurohet normalisht, kjo mund të ndikojë në qëndrimin e zyrтарit të rastit, i cili mund të pranojë apo jo këtë dokumentin si provë. Nëse kërkuesi ka marrë dokumente që nuk mund të merren normalisht, atij/asaj do t'i jepet mundësi që të shpjegojë se si i ka marrë.

Në rast të pashaportaveduhet të verifikohen vulat e hyrjes/daljes, vizat, treguesit se kërkuesi është kthyer në vendin e origjinës etj., për të konfirmuar historinë e imigrimit të kërkuesit, si edhe rrëfimin e ngjarjeve nga ana e kërkuesit, gjithçka me qëllim të vlerësimit të besueshmërisë.

Kur një ekspertizë e tillë është e disponueshme, dokumentet mund të shqyrtohen nga një specialist, për të përcaktuar nëse ato janë të vërteta ose ka gjurmë falsifikimi. Nëse përcaktohet që dokumentet janë të falsifikuara, kërkuesit do t'i jepet mundësi që të shpjegojë se si i ka marrë.

Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me mundësinë e paraqitjes së dokumenteve origjinale apo kopjeve, klikoni [këtu](#).

Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare, që përcaktojnë nëse përkthimet do të sigurohen nga kërkuesi ose autoritetit të Shtetit Anëtar, ju lutemi të klikoni [këtu](#).

1.3.2.2. Informacion për vendin e orgjinës (COI) [prapa]

Disponueshmëria e COI cilësore ka një rëndësi thelbësore për procesin e vendimmarrës. Zyrtari i rastit duhet të jetë i sigurt se informacioni që ai/ajo ka në dispozicion është relevant, i saktë dhe i azhurnuar dhe që ai vjen nga disa burime të ndryshme. Burime të tilla mund të përfshijnë njësitë kombëtare COI, EASO, UNHCR dhe organizatat e tjera relevante për të drejtat e njeriut.

Nëse informacioni nuk është i disponueshëm, zyrtari i rastit mund të ketë nevojë për të kërkuar ose hulumtuar informacion relevant për kërkesën.

Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me sigurimin e COI, klikoni [këtu](#).

1.3.2.3. Provat e tjera [prapa]

- **Raportet e ekspertëve [prapa]**

Zyrtarët e rastit mund të përdoren raporte të shumëllojshme, të cilat do t'i ndihmojnë në procesin vendimmarrës. Raportet e tilla do të sigurohen nga vetë kërkuesi ose nga autoriteti vendimmarrës.

Kërkuesit mund të mbështesin kërkesat e tyre me raporte që ofrojnë informacion lidhur me sfondin e tyre kulturor specifik, situatën e vendit ose aspekte të tjera relevante për kërkesën. Raportet e tilla mund të jenë veçanërisht të përdorshme në mungesë të COI nga burime të tjera, ose kur COI është i paqartë ose shumë të përgjithshëm.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se raporte të tilla do të pranohen në të njëjtën mënyrë si COI. Zyrtarët e rastit duhet të vendosin se sa rëndësi do t'u japin këtyre raporteve, kur do të vlerësojnë besueshmërinë e fakteve materiale të pretenduara dhe më vonë, kur do të vlerësojnë rrezikun e kthimit.

Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me mbledhjen e raporteve të ekspertëve dhe rrethanat, në të cilat ato mund të kërkojnë, klikoni [këtu](#).

- **Raportet mjekësore dhe psikologjike [prapa]**

Raportet nga personel klinik profesionalisht i kualifikuar, të cilat janë organizuar nga Shtetet Anëtare, kërkuesi ose përfaqësuesi i tij/saj dhe mbështesin pohimin që kërkuesi është torturuar ose nënshtruar lëndimit serioz, duhet t'u jepet rëndësia e duhur gjatë procesit vendimmarrës (**Neni 18 APD i ribotuar**). Nuk është roli i zyrtarit të rastit të bëjë vetë gjykime klinike lidhur me provat mjekësore ose çështje mjekësore në përgjithësi.

Përveç vlerësimit të çështjeve të tilla si gjurmët e torturës, raportet mjekësore mund të japin informacion të rëndësishëm lidhur me aftësinë e kërkuesit për të ofruar dëshmi të qarta dhe të hollësishme për atë që i ka ndodhur. Për shembull, një raport, që konfirmon që kërkuesi vuan nga trauma dhe, si pasojë, ka probleme për të kujtuar ngjarjet në mënyrë të qartë, mund të ndihmojë zyrtarin e rastit që të vendosë se si do të interpretojë provat e tij/saj dhe sa rëndësi t'u japë mungesave të dukshme të hollësisë ose koherencës.

- **Raportet e analizës së foljes [prapa]**

Zyrtarët e rastit mund të kenë qasje në raporte të analizës së foljes. Këto raporte lëshohen nga linduistqë flasin me individët, i dëgjojnë dhe, pas kësaj, arrijnë në një përfundim të arsyetuar lidhur me vendin e tyre të mundshëm të origjinës.

Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me pranueshmërinë e raporteve të tilla dhe mënyrën se si ato sigurohen, klikoni [këtu](#).

- **Informacion nga persona të tjerë (dëshmia e dëshmitarëve) [prapa]**

Përveç informacionit të ofruar nga ekspertë të kualifikuar në fushën e tyre, dëshmia mund të paraqitet/kërkohej edhe nga individë apo grupe të tjera që mund të ndihmojnë në vlerësimin e besueshmërisë së deklaratave të kërkuarit. Dëshmi të tilla mund të vijnë nga burime të ndryshme, duke përfshirë:

- Pjesëtarët e familjes
- Shkollat
- Grupet politike
- Grupet fetare

Këto prova duhet të shqyrtohen me kujdes dhe të vlerësohen, për të përcaktuar se si ato mbështesin apo kundërshtojnë deklaratat e kërkuarit. Kur Zyrtari i rasti mbledh prova të tilla, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet çështjes së konfidencialitetit. Zyrtari i rastit duhet të vendosë se sa rëndësi do t'i kushtojë një dëshmie të tillë dhe nëse dëshmitari është i besueshëm.

- **Informacion nga autoritetet shtetërore të Shtetit Anëtar. [prapa]**

ekziston mundësi që autoritetet e shteteve të tjera të kenë informacion i cili mund të ndihmojë në verifikimin e fakteve materiale të një aolikimi. Mund të jetë e përshtatshme të kërkohej informacion i tillë si për shembull:

- Gjurmët e gishtave EURODAC
- rregjistri i gjendjes civile
- Të dhënat e policisë/gjykatës
- Të dhënat mjekësore (pëlqimi i kërkuarit mund të jetë i nevojshëm në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet kombëtare)

Në rast të zyrtarët e Shteteve Anëtare mbledhin prova nga vendi i origjinës, duhet pasur kujdes të veçantë që kërkuari dhe personat e lidhur me të t'i mos nënshtrohen rrezikut.

- **Informacion nga shtetet e tjera anëtare. [prapa]**

Në disa rrethana, mund të jetë e përshtatshme të kërkohej informacion për kërkuarin nga një Shtet Anëtar tjetër, në të cilin ka banuar më parë. Për çdo kërkesë të tillë mund të ketë nevojë për pëlqimin e kërkuarit, lidhur me çështjet e konfidencialitetit.

Për të mësuar për dispozitat e udhëzimeve kombëtare lidhur me mënyrën se si duhen paraqitur këto kërkesa, klikoni [këtu](#).

Hapi 2 Vlerësimi i besueshmërisë [prapa]

Pasi zyrtari i rastit ka mbledhur të gjitha provat, ai/ajo do të fokusohet në vlerësimin e provave që mbështesin çdo fakt material.

2.1 Lidhni provat me secilin fakt material [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të kete parasysh se "faktet materiale" nuk janë te njejta me faktet e provuara, për shkak se "faktet" janë zakonisht term i përdorur në sistemin e drejtës civile, por kanë të bëjnë me teper me pretendimet e shprehura, të cilat në sistemin e azilit duhet të vlerësohen si të besueshme apo jo..

Gjatë procesit të mbledhjes së provave, është e domosdoshme të sigurohet që të gjitha provat e mbledhura janë relevante për faktet materiale të rastit. Në shumë raste, disa lloje provash mund të lidhen me më shumë fakte materiale (p.sh. intervista personale ose deklarata me shkrim).

Shihni [shabllonin](#) për të lidhur provat me faktet materiale.

2.2 Vlerësoni deklaratat e kërkuarit në bazë të treguesve të besueshmërisë. [prapa]

2.2.1 Bëni konstatime lidhur me besueshmërinë e brendshme [prapa]

Besueshmëria e brendshme përfshin mjaftueshmërinë e detajeve, aspektin specifik dhe përputhshmërinë.

2.2.1.1 Mjaftueshmëria e detajeve dhe aspekti specifik [prapa]

Cili është niveli i detajeve që kërkohet dhe sa detaje janë të nevojshme?

Zakonisht, sa më shumë **detaje** raportohen dhe janë në dispozicion, aq më i mirë është imazhi. Kjo lidhet me faktin se normalisht ngjarjet reale të përjetuara mund të raportohen më gjallërisht dhe në mënyrë më spontane. Megjithatë, zyrtari i rastit nuk duhet të harrojë se mund të ekzistojë një shpjegim i arsyeshëm, për të cilin kërkuari nuk mund të mbajë mend shtrembërimet e mundshme (shihni gjithashtu [2.4 Faktorët që mund të çojnë në shtrembërimet](#)). Për këtë arsye, mungesa e detajeve nuk ndikon në besueshmëri në të gjitha situatat.

Aspekti specifik lidhet me rrethanat personale dhe individuale, si edhe me mënyrën se si një ngjarje përjetohet dhe shprehet. Në shumë raste, tregimi i përgjithshëm mund të jetë i ngjashëm, por çdo rast ka aspekte specifike që e bëjnë unik. Në raste të tilla, mund të jetë e përdorshme të mos insistojmë në elementet kryesore, por të pyesim më shumë për ngjarjet dhe të punojmë në aspektet specifike në këtë mënyrë. Nëse aspektet specifike mungojnë në deklaratën e kërkuarit, kjo mund të sugjerojë mungesën e besueshmërisë.


Normalisht, intervista personale është burimi më i rëndësishëm i informacionit për mbledhjen e sa më shumë detajeve dhe aspekteve specifike, por kjo varet në një masë të madhe nga aftësitë e zyrtarit të rastit (i cili duhet të krijojë një atmosferë të mirë dhe të ketë teknika të mira intervistimi dhe njohuri për rastin), për të sqaruar detajet e materiale.

2.2.1.2 Përputhshmëria [prapa]

Zakonisht, përputhshmëria kuptohet si mungesa e mospërputhjeve, kontradiktave dhe variacioneve në faktet materiale të paraqitura nga kërkuari. Ajo ka të bëjë me:

- Deklaratat me gojë ose me shkrim të dhëna nga kërkuari në përgjithësi;
- deklaratat e ndryshme për të njëjtën temë në momente të ndryshme gjatë procedurës;
- informatat e ndryshme për të njëjtën temë nga provat e tjera të paraqitura nga kërkuari;

Testi me katër faza i paraqitur më poshtë mund të jetë i përdorshëm si një udhëzim për mënyrën se si zyrtari i rastit duhet të trajtojë (mos)përputhjet:



2.2.1.3 Sjellja nuk duhet të përdoret si tregues i besueshmërisë [prapa]

Sjellja përshkruan, në përgjithësi, sinjalet jo verbale të komunikimit, si edhe mënyrat e të sjellurit, duke përfshirë tonin e zërit, modulimin e të folurit, mënyrën e veprimit, shprehjen e fytyrës etj. Këto janë kryesisht të dukshme gjatë intervistës personale.

Zyrtari i rastit nuk duhet të mbështetet në sjelljen e kërkuesit si një tregues besueshmërie. Konstatimet që bazohen në sjelljen e kërkuesit janë të barabarta me supozime të thjeshta dhe gjykime subjektive në bazë të intuitës.

2.2.2. Bëni konstatime lidhur me besueshmërinë e jashtme [prapa]

Besueshmëria e jashtme i referohet përputhshmërisë me informacionin nga vendi i origjinës (COI), faktet e njohura dhe prova të tjera të mbledhura nga autoriteti vendimmarrës.

2.2.2.1 Përputhshmëria me COI [prapa]

COI mund të përdoret për disa aspekte lidhur me shqyrtimin e një kërkese. Ai mund të përdoret për të vërtetuar deklaratat e kërkuesit lidhur me faktet materiale, si edhe për të formuar provat e sfondit që do të përdoren në vlerësimin e rrezikut të kthimit.

- **COI mbështetës**

Nëse COI objektiv mbështet provat e kërkuesit, atëherë nuk ka asnjë arsye serioze për të dyshuar dhe fakti i pretenduar mund të pranohet.

- **COI kundështues**

COI që kundërshton në mënyrë të qartë faktin material të pretenduar është një faktor negativ besueshmërie. Për këtë arsye, kërkuesit duhet t'i jepet mundësia për të ofruar shpjegime shtesë.

- **Mungesa e COI**

Mungesa e COI nuk do të thotë se fakti/ngjarja e pretenduar nuk ka ndodhur. Për shembull, kjo mund t'i detyrohet qasjes së kufizuar në informata në vendin e origjinës ose rëndësisë së vogël të ngjarjes etj. Prandaj, vetë mungesa e COI nuk duhet të çojë në përfundime negative lidhur me besueshmërinë.

2.2.2.2 Përputhshmëria me informacion përgjithësisht të njohur [prapa]

Ka fakte që janë zakonisht të njohura dhe nuk mund të kontestohen në mënyrë të arsyeshme (siç janë për shembull ligjet e fizikës). Këto fakte nuk varen nga perceptime kulturore të ndryshme. Normalisht, nuk ka nevojë për të mbështetur fakte të tilla me dëshmi shtesë. Që të konsiderohen të besueshme, deklaratat e kërkuesit duhet të jenë në përputhje me informacionin përgjithësisht të njohur. Në zbatim të këtij koncepti, zyrtari i rastit duhet të ketë kujdes ta mos zgjerojë në koncepte që ai i merr si të mirëqena për shaka të përkatësisë së tij/saj sociale, kulturore dhe personale.

2.2.2.3 Përputhshmëria me prova të tjera [prapa]

Provat e tjera mund të përfshijnë deklarata nga vartësit dhe dëshmitarët, dokumente nga organet shtetërore të tjera, raportet e ekspertëve etj. Provat e tilla mund të mbështesin ose të kundërshtojnë deklaratat e kërkuesit. Si pikënisje, duhet të vlerësohet besueshmëria e brendshme e provave të tjera. Nëse prova është në kundërshtim me deklaratat e kërkuesit, zyrtari i rastit duhet të merret me këtë situatë dhe t'i japë kërkuesit mundësi për të shpjeguar këto mospërputhje. Zyrtari i rastit duhet të marrë parasysh këtë shpjegim.

2.2.3. Bëni konstatime lidhur me mundshmërinë (plausibilitetin) [prapa]

Që të jetë i mundshëm (plausibil) vargu e ngjarjeve duhet të ketë gjasa të arsyeshme dhe të duket i mundur për një person të arsyeshëm.

Zyrtarët e rastit duhet të jenë të vetëdijshëm se koncepti i besueshmërisë duhet të përdoret me kujdes, së paku për të parandaluar spekulimet dhe supozimet subjektive apo paragjykimet. Një fakt i pohuar mund të jetë plotësisht i mundshëm (plausibil), në qoftë se konsiderohet në kontekstin e rrethanave të kërkuesit, duke përfshirë gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, arsimin, sfondin social dhe kulturor, përvojat e jetës dhe rrethanat në vendin e origjinës ose të vendbanimit të zakonshëm etj. Zyrtari i rastit duhet të jetë i vetëdijshëm se mund të ketë dallime midis perspektivës së tij/saj dhe perspektivës së kërkuesit, të cilat mund të shpjegojnë pamundshmërinë (jo-plausibilitetin) e dukshme.

Pamundshmëria (jo-plausibiliteti) duhet të bazohet në interferenca të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme dhe objektivisht të justifikuar dhe zyrtari i rastit duhet të japë arsye të artikuluar për të konsideruar një deklaratë si e pamundshme.

Shihni [shabllonin](#) për të lidhur provat me faktet materiale.

2.3 Vlerësoni dokumentet [prapa]

Dokumentet duhet të vlerësohen sipas hapave të mëposhtëm:

- **Relevanca [prapa]**

Relevanca përcakton nëse një dokument lidhet me një fakt material specifik. Relevanca duhet të sqarohet me kërkuesin.

- **Ekzistenca [prapa]**

Ekzistenca përcakton nëse një lloj dokumenti ekziston sipas informacionit të përgjithshëm.

- **Përmbajtja [prapa]**

Elementet e mëposhtme duhet të vlerësohen:

- A përmban ndonjë kundërshti të brendshme?
- A është në përputhje me deklaratat e kërkuesit?
- A është në përputhje me COI?
- A është dokumenti i saktë? Saktësia i referohet në nivelit të detajeve relevante për një fakt material të caktuar.
- A është dokumenti rrëfimi i drejtpërdrejtë i një fakti material? A ka ardhur informacioni nga një burim të drejtpërdrejtë apo është rrëfimi i deklaratave të kërkuesit?

- **Forma [prapa]**

Forma e një dokumenti është e rëndësishme për të vlerësuar vërtetësinë e tij. Në varësi nga praktika kombëtare, ajo mund të përfshijë vlerësimin nga ana e një eksperti ose krahasimin me materiale referuese. Zyrtari i rastit duhet ketë kujdes, në qoftë se nxjerr përfundime mbi autenticitetin vetëm në bazë të formës së dokumentit, duke marrë parasysh që në disa vende dokumente të caktuara mund të mos kenë një formë të standardizuar.

- **Natyra [prapa]**

Elementi i natyrës së dokumentit u referohet disa çështjeve, duke përfshirë: a është dokumenti paraqitur në origjinal apo në kopje, në cilën gjendje është dokumenti dhe a prezanton ai ndonjë dëmtim ose gjurmë modifikimi. Zakonisht, dokumentet kanë më shumë vlerë në vlerësimin. Megjithatë, zyrtari i rastit duhet të mbajë mend se ka dokumente që nuk mund të merren në origjinal.

- **Autori [prapa]**

Zyrtari i rastit duhet të konstatojë kualifikimet e autorit, si edhe objektivitetin dhe/ose përvojën relevante të tij/saj.

Dokumentet duhet të merren parasysh së bashku me prova të tjera, me të cilat përcaktohet fakti material që ato duhet të mbështesin, si edhe elemente të tjera për vlerësimin e besueshmërisë. Një dokument duhet të vlerësohet në të njëjtën mënyrë si çdo provë tjetër. Është e papërshtatshme t'i mos jepet asnjë rëndësi një dokumenti, pa shpjeguar arsyet për të arritur këtë përfundim në bazë të provave të disponueshme, duke përfshirë informacionin objektiv për vendin nga burime të besueshme dhe prova të tjera lidhur me atë.

Shihni seksionin 1.3.2.1 për më shumë informacion lidhur me dokumentet e paraqitura nga kërkuesi.

Shihni [shabllonin](#) për konstatimin e besueshmërisë.

2.3.1 Vlerësoni provat mjekësore dhe psikologjike [prapa]

Një lloj shumë specifik provash, i lëshuar nga një person i kualifikuar, është dëshmia mjekësore ose psikologjike. Zyrtari i rastit nuk duhet të bëjë gjykime mjekësore ose të japë mendimin e vet lidhur me mjekimin e rekomanduar nga një mjek. Mjeku nuk duhet të bëjë gjykime të natyrës ligjore ose lidhur me besueshmërinë.

Raportet mjekësore ose psikologjike duhet të përfshijnë informata të mjaftueshme lidhur me kualifikimet e ekspertit mjekësor dhe metodat e ekzaminimit, në mënyrë që të mundësojnë vlerësimin e pavarur të besueshmërisë së tyre. Në pajtim me udhëzimet kombëtare, një vlerësim i tillë mund të kryhet nga zyrtari i rastit ose nga një ekspert.

Në rast të pretendimeve të torturës, për shembull, raportet mjekësore duhet të vlerësohen në krahasim me standardet e [Protokollit të Stambollit](#).

Në rast dyshimi, zyrtari i rastit mund të ketë mundësi të kërkojë një mendim të dytë, në përputhje me praktikën kombëtare. Për të mësuar dispozitat e udhëzimeve kombëtare, klikoni [këtu](#).

2.4 Kini parasysh faktorët individualë dhe rrethorë që mund të çojnë në shtrembërimë [prapa]

Gjatë shqyrtimit të besueshmërisë së provave në mbështetje të fakteve materiale, zyrtari i rastit duhet të mbajë mend që pozita individuale dhe rrethanat personale të kërkuarit mund të ndikojnë seriozisht në mënyrën se si kërkuari sheh dhe paraqet ngjarjet lidhur me kërkesën. Disa shtrembërimë në marrjen dhe interpretimin e informacionit mund të paraqiten lidhur me jetën dhe përvojën profesionale të zyrtarit të rastit, si edhe me paragjykimet.

Fenomene të tilla janë tipike për natyrën njerëzore dhe është praktikisht e pamundur të përjashtohen. Megjithatë, duhet t'i kemi parasysh kur kryejmë një intervistë personale (shihni **Udhëzuesin Praktik EASO për Intervistat Personale**) ose gjatë vlerësimit të besueshmërisë. Gjithashtu, duhet të analizojmë gjithmonë nëse faktorët individualë dhe subjektivë mund të ndikojnë në treguesit e besueshmërisë ose të shpjegojë një mospërputhje/mungesë konsekuente të dukshme në deklaratat e kërkuarit.

Shumë nga faktorët e shtrembërimit intersektohen shpesh me njëri-tjetrin. Ndërgjegjësimi për këta faktorë është i domosdoshëm për personat që punojnë në fushën e azilit. Një listë jo-shteruese e faktorëve të mundshëm që mund të çojnë në shtrembërimë tregohet më poshtë.

2.4.1. Faktorët lidhur me kërkuarin [prapa]

Deklaratat gojore janë provat kryesore (shumë shpesh të vetmet) të ofruara nga kërkuari. Kur zyrtari i rastit verifikon besueshmërinë e tyre, ai/ajo duhet të verifikojë nëse kërkuari ka pasur mundësi të kujtojë dhe të prezantojë faktet dhe nëse informacioni i paraqitur është perceptuar dhe kuptuar në mënyrë të përshtatshme. Shumë faktorë mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në këtë proces.

2.4.1.1 Kujtesa [prapa]

Kujtesa e njeriut ka shtresa dhe kufij dhe duhet të kemi këtë fakt parasysh kur punojmë me azilkërkuar, deklaratat e të cilëve mbështeten shumë shpesh vetëm në kujtesë. Kujtimi i detajeve të një ngjarjeje që ka ndodhur para shumë vitesh dhe përshkrimi i njerëzve të takuar në të kaluarën mund të përfaqësojnë vështirësi të mëdha.

Zyrtari i rastit duhet të ketë pritshmëri realiste lidhur me nivelin e detajeve të kujtesave të largëta dhe shpesh traumatike gjatë kryerjes së intervistës personale dhe analizës së mëvonshme të rezultateve. Mënyra e kryerjes së intervistës mund të ndikojë në sasinë e informacionit që mund t'i kujtohet kërkuarit. Pyetjet sugjестive duhen parandaluar gjatë intervistës, sepse ato mund të ndikojnë në rrëfimin e ngjarjeve nga ana e kërkuarit. Për udhëzime të mëtejshme shihni **Udhëzuesin Praktik EASO për Intervistat Personale**.

2.4.1.2 Trauma dhe PTSD [prapa]

Një raport relevant mjekësor apo opinionin e një psikologu në dosjen e kërkuarit përfaqëson zakonisht një provë të qartë, e cila konfirmon që personi në fjalë ka përjetuar një përvojë aq traumatike, sa që aftësia e tij/saj për të kujtuar ngjarjet e kaluara, ndjekur temën dhe ofruar një rrëfim të strukturuar është e penguar, madje e pamundësuar. Përvojat traumatike mund të çojnë gjithashtu në frikë dhe mungesën e besimit, të cilat mund të ndikojnë në sasinë dhe cilësinë e informacionit që kërkuari mund të ofrojë.

Deklaratat e personave që kanë përjetuar trauma ose vuajnë nga Çrregullimi i Stresit Post-Traumatik (PTSD) janë zakonisht të fragmentuara, të shkëputura nga një aks kohor, të pakontrolluara nga vullneti dhe të shkaktuara nga impulset shqisore. Personat e traumatizuar mund të evitojnë të flasin për përvojat e vështira.

Është e këshillueshme t'u jepni më shumë rëndësi rrethanave objektive të rastit sesa elementit subjektiv të frikës që e tregon kërkuesi. Kur shqyrtoni kërkesën e një personi të traumatizuar, zyrtari i rastit nuk duhet të ketë të njëjtin nivel të pritshmërive, kur zbaton treguesit e besueshmërisë (shihni [Seksionin 2.2 Përdorimi i treguesve të besueshmërisë](#)). Në veçanti, zyrtari i rastit duhet të ketë kujdes kur bën konstatime negative lidhur me besueshmërinë në bazë të deklaratave të kërkuesit.

Gjithashtu, duhet të kemi parasysh që ngjarjet ose përvojat traumatike mund të kenë ndodhur pas ikjes nga vendi i origjinës, duke përfshirë vendin, ku procedura e azilit zhvillohet.

2.4.1.3 Probleme të tjera psikologjike dhe shëndetësore [prapa]

Vështirësitë për të ofruar deklarata të qarta dhe koherente mund të burojnë nga problemet shëndetësore dhe varësitë e kërkuesit, p.sh. pirja e ilaçeve të forta, aftësitë e kufizuara mendore, depresioni apo varësia nga droga ose alkooli. Mungesa e njohurive rreth këtyre faktorëve dhe dështimi për t'i përballuar mund të çojnë në përfundime të gabuara lidhur me besueshmërinë.

2.4.1.4 Moshë [prapa]

Faktori i moshës mund të jetë vendimtar gjatë vlerësimit të besueshmërisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rast të të miturve të pashoqëruar, ose kur të miturit janë intervistuar si dëshmitarë në rastin e prindërve (kujdestarëve) të tyre.

Deklaratat e një fëmije mund të jenë jokonsekuente dhe të përmbajnë shprehje ose deklarata të paqarta që ata kanë dëgjuar nga të rriturit që udhëtonin me ta ose nga të afërmit e tyre etj. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që intervista është kryer në një mënyrë miqësore për fëmijët (shihni **Udhëzuesin praktik EASO për intervista personale**).

Moshë është një faktor i rëndësishëm edhe për kohën kur deklaratat jepen edhe për kohën kur ngjarja është përjetuar.

Në varësi nga rrethanat, shtrembërimet e lidhura me moshën mund të jenë të rëndësishme edhe në rast të personave të moshuar.

2.4.1.5 Arsimi [prapa]

Dallimet në nivel arsimor mund të ndikojnë në aftësinë për të shikuar dhe kujtuar ngjarjet, si edhe për të artikuluar përmbajtjen e nevojshme ose për të kuptuar pyetjet në mënyrë të duhur. Përgjigjet lakonike dhe të ngathëta ose gabimet në datat dhe distancat mund të tregojnë një leksik të kufizuar, njohuri të përgjithshme të kufizuara, paaftësi për të kuptuar dhe për të përshkruar kushtet abstrakte ose mungesën e vetëdijes që ka nevojë për një deklaratë të hollësishme.

2.4.1.6 Kultura, feja dhe besimet [prapa]

Kultura, feja dhe besimet e një personi përcaktojnë mënyrën në të cilën ai/ajo definojnë identitetin e tij/saj, percepton rolet sociale dhe marrëdhëniet e pushtetit, kupton, interpreton dhe ritregon informacion. Datat, stinët, distancat, koha e inicimit social ose përfshirjes në jetën publike, nocioni i familjes së ngushtë dhe gjuha trupore mund të ndryshojnë në varësi nga këta faktorë.

Faktorët e tjerë si arsimi, moshë, gjuha, gjinia, statusi social dhe zakonet janë gjithashtu të rëndësishme në këtë drejtim.

Kur zyrtari i rastit vlerëson besueshmërinë e një pretendimi, ai/ajo duhet të jetë i vetëdijshëm/e vetëdijshme për dallimet e mundshme si pasojë e sfondit kulturor dhe/ose fetar. Kompetenca ndërkulturore është shpesh e nevojshme për të shikuar informacionin nga një perspektivë e ndryshme. Ajo ndihmon në deshifrimin e deklaratave që duken në kundërshtim me një kod kulturor.

Megjithatë, zyrtari i rastit nuk duhet të transformojë kërkuesin në "një burg" të kulturës së tij/saj, d.m.th. zyrtari i rastit nuk duhet të supozojë apriori se një person që vjen nga një sfond kulturor ose fetar i caktuar duhet të veprojë në një mënyrë të caktuar, dhe si pasojë, të përmbahet nga diskutimi i një çështjeje potenciale të besueshmërisë. Vetëm pasi zyrtari ka pyetur dhe nuk ka marrë një përgjigje, ai duhet të verifikojë nëse ka barriera kulturore, sociale, fetare ose të tjera që mund të shkaktojnë një çështje të caktuar besueshmërie.

2.4.1.7 Orientimit seksual dhe identiteti gjinor (SOGI) [prapa]

Çështjet e lidhura me SOGI janë shpesh të ndjeshme dhe kërkojnë njohuri të veçanta mbi këtë temë, si edhe vëmendje të veçantë në vlerësimin e besueshmërisë. Zyrtari i rastit nuk duhet të barazojë këtë udhëzim me pranimin e gjithçkaje që kërkuesi thotë pa asnjë analizë. Megjithatë, një nivel i lartë i vetëdijeje dhe respekti për dinjitetin dhe diversitetin e njerëzve është i nevojshëm, sepse në këto raste deklaratat e kërkuesit janë të lidhura drejt me çështje personale shumë delikate.

Personat që paraqesin kërkesa lidhur me SOGI që nuk janë të pranueshme në vendet e tyre të origjinës duhet të fshihin shpesh identitetin, ndjenjat dhe mendimet e tyre të vërteta, për të parandaluar turpin, izolimin, stigmatizimin dhe shumë shpesh edhe rrezikun e dhunës. Stigmatizimi dhe ndjenjat e turpit mund ta pengojnë kërkuesin që të zbulojë informacion në kontekstin e azilit. Ka shumë raste, në të cilat kërkues zbulon që është lesbike, homoseksual, biseksual, transeksual apo interseksual vetëm në një kërkesë të mëvonshme.

Zyrtari i rastit duhet të përmbahet nga supozimet stereotipike lidhur me sjelljen ose pamjen e pjesëtarëve të pakicave seksuale, duke pasur parasysh se faktorë të tjerë, siç janë sfondi kulturor dhe social, arsimimi dhe gjinia, mund të ushtrojnë një ndikim të fuqishëm mbi një kërkues të caktuar.

2.4.1.8 Gjinia [prapa]

Gjinia nuk ka të bëjë me seksin biologjik, por u referohet pritshmërive të veçanta të një shoqërie ndaj mënyrës se si gratë dhe burrat duhet të sillen, balancës së pushtetit mes gjinive, roleve dhetributeve të tyre në shoqëri etj. Rolet gjinore ndikojnë jo vetëm në perceptimin e vetvetes, por edhe në sjelljen dhe qëndrimin ndaj jetës sociale dhe politike, si edhe në mënyrat e përndjekjes ose lëndimit. Ato mund të ndryshojnë në varësi nga gjinia e viktimës dhe dhunuesit.

Kërkuesi mund të mos jetë i vetëdijshëm se një sjellje e caktuar ndaj tij/saj mund të konsiderohet si një shkelje e të drejtave të tij/saj njerëzore, sepse ashtu e kanë trajtuar tërë jetën. Nga ana tjetër, stigmatizimi dhe/ose ndjenja e turpit mund të pengojnë kërkuesin që të zbulojë informacion.

2.4.2 Faktorët e lidhur me zyrtarin e rastit [prapa]

Puna në fushën e azilit nënkupton punën e vazhdueshme me njerëz nga kultura, prejardhje sociale dhe përvoja jetësore të ndryshme. Kjo është një nga faktorët që e bëjnë punën e zyrtarit të rastit aq interesante. Megjithatë, edhe zyrtari i rastit është një njëri dhe mund të përjetojë stres dhe frustrim në këtë mjedis sfidues të punës.

Faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në objektivitetin e zyrtarit të rastit:

2.4.2.1 Jini të vetëdijshëm për efektin e stresit, ngarkesës së punës dhe afatëve [prapa]

Stresi, ngarkesa e punës dhe afatet e shkurtraveprojnë së bashku shpesh dhe mund të kenë një ndikim vendimtar në vlerësimin përfundimtar të kërkesës.

Në punën e tij/saj të përditshme, zyrtari i rastit duhet të përmbushë objektive sasiore, të hartojë vendime të justifikuara në kohën e duhur dhe të merret me kërkues që nuk bashkëpunojnë ose kanë pasur përvoja personale shumë traumatike.

Të mos harrojmë se zyrtari i rastit ka jetën e tij/saj private, e cila mund të përfaqësojë një burim problemesh dhe situatash stresuese që mund të ndikojnë në qëndrimin e tij/saj ndaj detyrave profesionale, si edhe në aftësinë e tij/saj për të përballuar stresin në punë. Edhe një gjëra të parëndësishëm siç janë uria, dhimbja e kokës ose acarimi, mund të shtrembërojnë procesin e vlerësimit të besueshmërisë. Zyrtari profesional i rastit duhet të jetë i vetëdijshëm për këta faktorë dhe të bëjë një përpjekje të vazhdueshme për të minimizuar ndikimin e tyre.

Para se të nxjerrë një përfundim mbi besueshmërinë e provave të caktuara ose mbi besueshmërinë e përgjithshme, zyrtari i rastit duhet të përpiqet të përqendrohet vetëm në rastin konkret. Mund të jetë e përdorshme që të marrë një pushim të shkurtër para se të marrë një vendim lidhur me besueshmërinë.

2.4.2.2 Jini të vetëdijshëm për efektin e ekspozimit afatgjatë ndaj kërkesave të azilit [prapa]

Ekspozimi disavjeçar ndaj tregimeve të torturës dhe keqtrajtimit të rrëfyera nga kërkuesit (jo gjithmonë të besueshme) mund të shkaktojnë efekte të ndryshme që variojnë nga rutina dhe paaftësia për të shikuar çdo rast në mënyrë të paanshme dhe individuale, deri në traumatizimin sekondar dhe shfaqjen e simptomave të ngjashme me ato të personave që vuajnë nga PTSD.

Ekspozimi i afatgjatë në tregimet e azilit mund të shkaktojnë që zyrtari i rastit të jetë i prirur të parandalojë të depërtojë më thellë në deklaratat, që të mos dëgjojë tregime traumatike, dmth ato mund të tregojnë në "shterjen e dhembshurisë" ose në "ngurtësim ndaj rasteve". Në raste të tilla, zyrtari i rastit mund të jetë më i prirur për të nxjerrë përfundime të pabaza, pa kryer një vlerësim të duhur për besueshmërinë.

2.4.2.3 Parandaloni paragjykimet dhe stereotipet [prapa]

Kategorizimi i personave të sapotakuar, duke përdorur skema stereotipike në memorizimin ose përballimin e detyrave të përsëritura është normale për qeniet njerëzore dhe shumica prej nesh bën kështu. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që të jemi gjithmonë të mendjehapur, pavarësisht nga përvoja personale dhe profesionale të mëparshme. Përndryshe, rrëfimi i ngjarjeve, ashtu siç prezantohet nga kërkuesi, mund të të pranohet në mënyrë të duhur ose të keqkuptohet.

Qëllimi është të parandalohet nxirrja e përfundimeve të paracaktuara mbi rastin e një kërkuesi që ka karakteristika të ngjashme me ato të disa rasteve të mëparshme, në të cilat janë bërë konstatime të caktuara lidhur me besueshmërinë.

2.4.2.4 Rëndësia e vetëvlerësimit dhe mbikëqyrjes [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të reflektojë për punën, nevojat dhe vështirësitë e tij/saj të mundshme, të cilat i ka takuar ndërsa ka punuar në raste të caktuara të azilit. Mund të jetë e këshillueshme që të diskutohen këto gjëra me kolegët, një psikolog ose një mbikëqyrës, me qëllim për të marrë mbështetjen e nevojshme dhe për të përmirësuar vetë-njohurinë ose për të identifikuar trajnime plotësuese dhe/ose freskuese.

Mungesa e sugjerimeve pozitive, pritshmëritë e paqarta të eprorëve ose treguesit e performancës gjenerojnë shpesh stres dhe mund të çojë në raskapitje. Mbikëqyrja e rregullt dhe përgjigja ndaj shqetësimeve të zyrtarit të rastit mund të përmirësojnë motivimin profesional dhe të lehtësojnë shkëmbimin e përvojës.

2.4.3. Faktorët që lidhen me situatën e intervistës [prapa]

Disa aspekte lidhur me situatën e intervistës mund të ndikojnë në deklaratat e kërkuesit: Konteksti formal i bisedës, e cila mund të jetë e vështirë për kërkuesin; pritshmëria për të diskutuar jetën personale me persona të huaj; prania e një fëmije që e shpërqendron kërkuesin dhe trysnia e kohës, për shkak të kohës së kufizuar të caktuar për intervistën. Të gjitha këto aspekte duhen zgjidhur para dhe gjatë intervistës personale për të minimizuar ndikimin e situatës së intervistës në deklaratat. Këto aspekte duhet të merren parasysh edhe gjatë analizës së besueshmërisë së kërkuesit.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se deklaratat gojore e kërkuesit jepen shpesh në një gjuhë që nuk është gjuha e parë e kërkuesit dhe/ose nëpërmjet një përkthyesi. Ky faktor mund të jetë një burim shtrembërimesh, për të cilin zyrtari i rastit duhet të jetë i vetëdijshëm.

Autoriteti i azilit është në detyrë të sigurojë një përkthyes kompetent dhe të besueshëm për intervistën e azilit. Megjithatë, përkthyesi është një qenie njerëzore dhe në mënyrë të pashmangshme vepron si një "filtër" shtesë i informacionit që ai/ajo dëgjon ose lexon.

Shihni gjithashtu **Udhëzuesin Praktik EASO për intervistat personale** lidhur me rolin e përkthyesit.

Në vijim tregohen disa shembuj të rezultateve të mundshme të shtrembërimeve që lidhen me barrierat gjuhësore dhe kontekstin e intervistave:

- Duke vlerësuar besueshmërinë, zyrtari i rastit duhet të mbajë mend se disa **mungesa konsekuente ose mospërputhje të dukshme në deklaratat e kërkuarit ose dokumentet e përkthyer mund të jenë pasoja e pengesave gjuhësore** (p.sh. një fjalë që ka kuptime të ndryshme në varësi nga konteksti, mungesa e njohurive të përkthyesit për ekuivalentin e saktë të fjalës në gjuhën e vendit të azilit etj).
- **Ankthi, turpi ose mosbesimi i kërkuarit në përkthyesin** e pranishëm në intervistë mund të pengojnë kërkuarin që të thotë të vërtetën ose të sigurojë informacion më të detajuar. Faktorë të tjerë të përmendur më parë, siç janë gjinia, sfondi kulturor dhe frika e stigmatizimit, mund të luajnë një rol në raste të tilla.
- Një aspekt tjetër është kur kërkuari pretendon se mospërputhjet midis deklaratës së tij/saj të tanishme dhe deklaratave të mëparshme janë pasoja e **mungesës së kompetencës gjuhësore të përkthyesit** (ose paaftësisë së vet gjuhësore nëse nuk janë përdorur shërbimet e një përkthyesi), megjithëse, në fakt, deklaratat që ai/ajo ka dhënë janë thjeshtësisht jokonsekuente.

Kurdo qoftë është e mundur, zyrtari i rastit duhet t'i ofrojë kërkuarit mundësi që të shpjegojë mospërputhjet e dukshme dhe më në fund të vlerësojë nëse shpjegimi do të pranohet në rastin specifik.

2.5 Përcaktoni se cilat janë faktet materiale që do të pranohen [prapa]

2.5.1. Shikoni të gjitha provat lidhur me çdo fakt material në tërësi [prapa]

Zyrtari i rastit nuk duhet të nxjerrë përfundime për besueshmërinë e një fakti material, duke shikuar provat në izolim. Çdo prove dokumentare dhe gojore duhet t'i jepet rëndësi, e madhe ose e vogël. Vlerësimi i çdo prove dhe rrethanave të saj do të ndikojnë në "cilësinë" dhe domethënien e provës për rastin dhe prandaj edhe në rëndësinë që zyrtari i rastit duhet t'i japë. Kur zyrtari i rastit shqyrton të gjitha provat e lidhura me çdo fakt material dhe konsideron rëndësinë e secilës, ai/ajo duhet të dallojë nëse ato janë mbështetëse apo kundërthënëse.

2.5.1.1. Përcaktoni se cilat fakte janë të provuara (të pranuar) apo jo (të refuzuara) [prapa]

Duke shqyrtuar provat, zyrtari i rastit do të jetë në mundësi të pranojë ose të refuzojë faktet materiale.

Faktet e pranuar: Një fakt i pohuar mund të pranohet për shkak se, kur merren parasysh rrethanat individuale dhe kontekstuale të kërkuarit dhe, nëse është e nevojshme, arsyeshmëria e shpjegimeve të ofruara nga kërkuari lidhur me konstatime potencialisht negative për besueshmërinë, deklaratat e kërkuarit për këtë fakt janë:

- mjaft të detajuara;
- konsekuente nga pikëpamja e brendshme;
- në përputhje me informacionin e ofruar nga anëtarët e familjes dhe dëshmitarët;
- në përputhje me informacionin specifik dhe të përgjithshëm të disponueshëm;
- të mundshme (plausibile) nën dritën e rrethanave të veçanta dhe kontekstuale të kërkuarit;
- dhe sidomos kur mbështeten nga dokumente bindëse ose prova të tjera (dmth në bazë të besueshmërisë, kredibilitetit dhe rëndësisë së provave të tilla);

Faktet e refuzuara: Një fakt i pohuar mund të refuzohet sepse, kur merren parasysh arsyeshmëria e shpjegimeve të ofruara nga kërkuari në lidhje me konstatime potencialisht negative për besueshmërinë dhe rrethanat individuale dhe kontekstuale të kërkuarit, deklaratat e kërkuarit lidhur me këtë fakt nuk janë mjaft të detajuara, konsekuente dhe të mundshme dhe/ose janë në kundërshtim me provat e tjera objektive të besueshme.

2.5.1.2. Përcaktoni se cilat fakte janë akoma të pasigurta amja [prapa]

Ka fakte që mund të jenë të besueshme nga pikëpamja e brendshme (konsekuente dhe të mundshme) dhe nuk janë në kundërshtim me informacionin specifik dhe të përgjithshëm të disponueshëm, por mbeten të pasigurta për shkak se ato nuk mbështeten nga dokumente ose prova të tjera ose ato janë fakte për të cilat mbetet një element dyshimi. Këto elemente duhet të vlerësohen më tutje për të përcaktuar nëse do të pranohen ose refuzohen.

2.5.2. Zbatoni Nenin 4 (5) QD në ato faktet materiale që mbeten të pasigurta (përfitimi i dyshimit) [prapa]

Pavarësisht nga përpjekjet e kërkuesit dhe autoritetit vendimmarrës për të mbledhur prova në mbështetje të fakteve materiale të pohuara nga kërkuesi, ndoshta ka akoma paqartësi lidhur me disa nga faktet.

Në raste të tilla **Neni 4(5) QD** lejon që zyrtari i rastit të nxjerrë përfundime të qarta lidhur me pranimin e faktit material të pohuar dhe të zgjidhë dyshimet:

"Kur Shtetet Anëtare zbatojnë parimin, sipas të cilit kërkuesi është në detyrë të provojë kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare, dhe kur disa aspekte të deklaratave të kërkuesit nuk mbështeten nga dokumente ose prova të tjera, këto aspekte nuk duhen konfirmuar, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Kërkuesi ka bërë një përpjekje të sinqertë për të mbështetur kërkesën e vet;
- b) të gjitha elementet relevante në dispozicion të kërkuesit janë paraqitur dhe një shpjegim i kënaqshëm është ofruar lidhur me ndonjë mungesë të elementeve të tjera të rëndësishme;
- c) deklaratat e kërkuesit janë konsekuente dhe të mundshme dhe nuk janë në kundërshtim me informacionin specifik dhe të përgjithshëm relevant për rastin e kërkuesit;
- d) kërkuesi ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në kohën më të hershme të mundshme, përveç rastit kur kërkuesi mund të demonstrojë arsye të mira, për të cilat ai/ajo nuk ka bërë kështu dhe
- e) **besueshmëria e përgjithshme e kërkuesit është provuar".**

Neni 4 (5) QD parashikon përfitimin e dyshimit edhe në sistemet e disa Shteteve Anëtare.

Pesë kriteret e **Nenit 4(5) QD** janë kumulative. Kjo do të thotë se zyrtari i rastit duhet të jetë i kënaqur nëse të gjitha ato plotësohen (në një farë mase). Kur të gjitha pesë kriteret plotësohen, zyrtari i rastit duhet të zbatojë **Nenin 4 (5) QD** (dmth të japë përfitimin e dyshimit) dhe të pranojë faktin material. Në fund të fundit, nuk ka arsye të mira për të mos bërë kështu.

Megjithatë, zyrtari i rastit duhet balancojë në mënyrë të arsyeshme pikët "a", "b", "c", "d" dhe "e", duke marrë parasysh rrethanat individuale dhe kontekstuale të kërkuesit. Kjo do të thotë se zyrtari i rastit duhet të vlerësojë se në çfarë mase çdo kriter plotësohet apo jo. Ndoshta shkalla e lartë e plotësimit të një kriteri (për shembull deklarata shumë të forta) do të kompensojë shkallën më të ulët, në të cilën një kriter tjetër është plotësuar (për shembull shpjegime të dobëta për faktin që kërkuesi nuk ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në kohën më të hershme të mundshme).

Shihni seksionin 1.2.1 për më shumë udhëzime lidhur me pikët "a" dhe "b" dhe seksionet 2.2 - 2.4 për më shumë udhëzime lidhur me pikën "c". Ky seksion ofron udhëzime të mëtejshme në lidhje me pikën "e":

Besueshmëria e përgjithshme e kërkuesit është demonstruar (Neni 4 (5) (e) QD):

Kur vlerësohet nëse një fakt material është demonstruar, zyrtari i rastit do të shqyrtojë atë që ne mund të quajmë "rekordi i besueshmërisë" i kërkuesit. Me fjalë të tjera, zyrtari i rastit do të marrë parasysh konstatimet (pozitive/negative) lidhur me besueshmërinë, që ai/ajo ka bërë gjatë vlerësimit të fakteve të tjera materiale.

Për më tepër, disa fakte mund të bëhen relevante për vlerësimin e besueshmërisë së përgjithshme të kërkuesit, edhe në qoftë se ato nuk janë fakte materiale.

Faktorë të tjerë mund të ndikojnë në rekordin e përgjithshëm të besueshmërisë të kërkuesit:

- Sjellje që tregon se kërkuesi nuk ka ose ka pushuar të ketë frikë të kthehet në vendin e tij/saj të origjinës; ose
- sjellje e kërkuesit që tregon se ai/ajo fsheh informacion, gënjen ose pengon/vonon marrjen e një vendimi lidhur me kërkesën.

Duhet t'i jepet rëndësi çdo faktori në varësi nga rrethanat e rastit. Zyrtari i rastit duhet të ketë parasysh që pikët në favor të kërkuesit mund të tejkalojnë pikët kundër tij/saj.

Nëse zyrtari i rastit arrin në përfundim se besueshmëria e përgjithshme është aq e pamjaftueshme saqë të refuzojë faktin material, atëherë zyrtari i rastit është në detyrë të shpjegojë se pse ai/ajo konsideron që kjo dëmton besueshmërinë e kërkesës.

Në fund të procesit të vlerësimit të besueshmërisë, çdo fakt material duhet të kategorizohet si "i pranuar" ose "i refuzuar" dhe kjo nënkupton se zyrtari i rastit ka arritur në një përfundim të qartë për çdo fakt material.

Shihni [shabllonin](#) për pranimin dhe refuzimin e fakteve materiale.

Hapi 3 Vlerësimi i rrezikut [prapa]

Vlerësimi i rrezikut është analiza largpamëse për të përcaktuar nevojën e një kërkuesi specifik për mbrojtje ndërkombëtare.

Kërkuesi nuk duhet të jetë domosdo i besueshëm në çdo aspekt të kërkesës, që t'i jepet mbrojtje ndërkombëtare.

Zyrtari i rastit do të vlerësojë kërkesën në pajtim me vlerësimin e rrezikut dhe në bazë të të gjitha fakteve materiale që janë pranuar, para se të arrijë në një konkluzion përfundimtar lidhur me kërkesën.

3.1. Analizoni frikën e justifikuar nga përndjekja/rrezikun real të lëndimit të rëndë [prapa]

Analiza e frikës së justifikuar të kërkuesit dhe analiza e rrezikut real të lëndimit serioz, në të cilin kërkuesi mund të ekspozohet në rast kthimi, janë hapi i fundit në shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Rreziku i ardhmen analizohet në bazë të fakteve në dispozicion të zyrtarit të rastit në kohën kur vendimi është marrë. Vështirësitë për të prognozuar se çfarë do të ndodhet nëse kërkuesi kthehet sot, nesër ose në të ardhshmen e afërt dhe mungesa e një strukture vendimmarrëse të qartë mund të shkaktojnë që zyrtari i rastit të marrë vendime me bazë subjektive. Në rast gabimi, vendimet negative lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare mund të çojnë në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që vlerësimi i rrezikut të bazohet në një metodologji objektive dhe jo në spekulime. Qëllimi i hapave paraprakë të përshkruar në këtë udhëzues është të krijohet një bazë, e cila do të shërben si pikënisje për vlerësimin e rrezikut.

Kur zyrtari i rastit vlerëson rrezikun, ai/ajo kryen një analizë rreziku në bazë të fakteve materiale të konfirmuara përmes provave standarde relevante, të cilat përdoren për të demonstruar frikën e justifikuar të përndjekjes ose rrezikun real të lëndimit serioz.

3.1.1. Zbatoni Nenin 4(3) QD [prapa]

Neni 4(3) QD parashikon si më poshtë në lidhje me vlerësimin e kërkesës së azilit në tërësinë e saj:

Vlerësimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare kryhet në bazë individuale dhe merr parasysh:

- (a) të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me vendin e origjinës në kohën e marrjes së vendimit për kërkesën, duke përfshirë ligjet dhe rregulloret e vendit të origjinës dhe mënyrën në të cilën ato zbatohen;
- (b) deklaratat përkatëse dhe dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi, duke përfshirë informacionin që përcakton nëse kërkuesi i është nënshtruar ose mund t'i nënshtrohet përndjekjes ose lëndimit serioz;
- (c) pozitën individuale dhe rrethanat personale të kërkuesit, duke përfshirë edhe faktorë të tillë, siç janë sfondi, gjinia dhe mosha, në mënyrë që të vlerësohet, në bazë të rrethanave personale të kërkuesit, nëse veprimet, të cilave kërkuesi është nënshtruar ose mund të nënshtrohet, përfaqësojnë përndjekje ose lëndim serioz;
- (d) nëse aktivitetet e kërkuesit që nga ikja nga vendi i origjinës kanë qenë të lidhura vetëm me qëllimin të krijohet kushtet e nevojshme për marrjen e mbrojtjes ndërkombëtare, dmth duhet të vlerësohet nëse këto aktivitete do t'ia ekspozojnë kërkuesin rrezikut të përndjekjes ose lëndimit të rëndë në qoftë se do të kthehet në vendin e origjinës;
- (e) nëse kërkuesi mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme mbrojtjen e një vendi tjetër, ku ai mund të marrë shtetësinë.

3.1.2 Kini parasysh përndjekjen dhe lëndimin serioz në të kaluarën ose mungesën e tyre [prapa]

Zyrtari i rastit duhet të ketë parasysh që ekzistenca e përndjekjes ose lëndimit serioz në të kaluarën mund të modifikojë jo vetëm detyrimin për administrimin e provës (shihni [seksionin 1.2.3.1 Rregullat specifike për administrimin e provave](#)), por edhe standardin e aplikueshëm për provat. Në [Nenin 4\(4\) QD](#) parashikohet se faktiqë kërkuesi ka pësuar tashmë përndjekje ose lëndim serioz ose që i janë drejtuar kërcënime të drejtpërdrejta të përndjekjes ose dëmtimit serioz përfaqëson një tregues serioz, i cili justifikon frikën e kërkuesit që ai/ajo do të pësojë përsëri përndjekje ose lëndim serioz, përveç rastit kur ka arsye të mira për të konsideruar që përndjekja ose lëndimi serioz nuk do të përsëriten.

Hapat e mëparshme të vlerësimit të provave duhet t'i mundësojnë zyrtarit të rastit të konkludojë se çfarë i ka ndodhur kërkuesit në të kaluarën dhe të tashmen.

Fakti se kërkuesi ka pësuar më parë përndjekje nuk do të thotë domosdo që ekziston rreziku i përndjekjes së ardhshme, madje në qoftë se ka tregues serioz në këtë drejtim.

Duhet të marrim parasysh edhe që mungesa e përndjekjes në të kaluarën nuk nënkupton mungesën e përndjekjes në të ardhmen.

Që të kryejë vlerësimin përfundimtar të rastit, zyrtari i rastit duhet të shqyrtojë mbizotërimin e ngjarjeve të mëparshme lidhur me atë që kërkuesi është dhe situatën në vendin e tij/saj të origjinës.

3.1.3 Zbatoni standardin e provës [prapa]

Elementet e listuara në [Nenin 4\(3\) QD](#) duhet të analizohen në lidhje me standardin e zbatueshëm për administrimin e provave, në mënyrë që të jemi në mundësi të kryejmë vlerësimin e rrezikut. Standardi për administrimin e provave që zbatohet më së shpeshti në vlerësimin e frikës së justifikuar të përndjekjes dhe lëndimit serioz është "shkalla e arsyeshme e gjasave". Në çdo rast, standardi i zbatueshëm për administrimin e provave duhet të jetë më i ulët sesa koncepti "përtej dyshimit të arsyeshëm".

Nëse ju doni të mësoni për zbatimin e udhëzimeve kombëtare lidhur me standardet e zbatueshme për administrimin e provave, klikoni [këtu](#).

Instrumentet ligjore dhe lidhjet kombëtare

Instrumentet ndërkombëtare

Konventa e Gjenevës e vitit 1951 dhe Protokollit i Nju Jorkut i vitit 1967 për statutin e refugjatëve

- Teksti i Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967 janë në dispozicion në gjuhë të ndryshme në <http://www.refworld.org/docid/3be01b964.html>

Protokollit i Stambollit (Kombet e Bashkuara)

Manual për hetimin dhe dokumentimin e efektshëm të torturës dhe ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese nga 9 gusht 1999

- Teksti i Protokollit të Stambollit është në dispozicion në gjuhë të ndryshme në <http://www.refworld.org/docid/4638aca62.html>

Instrumentet e Bashkimit Evropian

Direktiva e kualifikimit (e modifikuar) [QD]

DIREKTIVA 2011/95/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 13 dhjetor 2011 për standardet përcilësimin e shtetasve të vendeve të treta ose personavepa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, përnjë status uniform për refugjatët dhe për personat e pranueshëm për mbrojtje plotësuese dhe përmbajtja e mbrojtjes së dhënë (e modifikuar)

- Teksti i QD është në dispozicion në gjuhë të ndryshme në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?qid=1422980659651&uri=CELEX:32011L0095>

Direktiva e procedurës së azilit (e modifikuar) [APD e modifikuar]

DIREKTIVA 2013/32/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare (ndryshoj)

- Teksti i APD-së së modifikuar është në dispozicion në gjuhë të ndryshme në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32013L0032>

instrumentet ligjore dhe udhëzimet kombëtare

Udhëzimet kombëtare për deklaratat me shkrim [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për dokumentet e paraqitur nga kërkuesi [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për marrjen e COI [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për raportet e ekspertëve [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për raportet e analizës gjuhësore [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për mbledhjen e informacionit nga Shtetet e tjera Anëtare [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për kërkimin e mendimit të ekspertëve mjekësorë/psikologjikë [\[prapa\]](#)

Udhëzimet kombëtare për standardin e administrimit të provave [\[prapa\]](#)

Shabllonet për vlerësimin e provave

Një version Word i shablloneve mund të gjendet këtu si shtojcë këtij Udhëzuesi Praktik.

Shablloni është krijuar për ta plotësuar gjatë fazave të ndryshme të procesit të punës, ndërsa merremi me një rast individual.

Qëllimi është të kemi një pasqyrë të qartë të të gjitha fakteve materiale të identifikuara dhe të provave të paraqitura nga kërkuesi dhe të mbledhura nga zyrtari i rastit (hapi 1). ⇒ Pas përgatitjes së kësaj pasqyre, ju mund të kaloni në hapin vijues, në të cilin ju

mund të formuloni mendimin tuaj për besueshmërinë e çdo prove (hapat 2.1 - 2.4) ⇒ dhe mbi këtë bazë ju do të vendosni se cilat fakte materiale do të pranoni dhe cilat do të refuzoni (hapi 2.5), duke zbatuar Nenin 4 (5) QD, nëse është e nevojshme. ⇒ Së fundi, ju të kryeni vlerësimin e rrezikut në bazë të fakteve materiale të pranuar (hapi 3).

Hapi 1: Mbledhja e informacionit			Hapat 2.1-2.4: Vlerësimi i besueshmërisë	
Për sa i përket ...	Cilat janë faktet materiale?	Cilat janë provat lidhur me faktet materiale?		Cilat janë konstatimet e besueshmërisë lidhur me provat, duke marrë parasysh rrethanat individuale dhe kontekstuale?
... vendit të origjinës:			→	
... Problemeve të kaluara dhe frikës nga e ardhmja:			→	
... arsyeve, për të cilat kërkuesi ka përjetuar/ka frikë nga probleme:			→	
... arsyeve, për të cilat kërkuesi nuk mund ose nuk dëshiron të kërkojë mbrojtje nga vendi i origjinës:			→	
... arsyeve, për të cilat kërkuesi duhet të përjashtohet:			→	

	Cilat rrethana individuale dhe kontekstuale të tjera janë të rëndësishme?	Cilat janë provat në lidhje me këto rrethana individuale dhe kontekstuale?	Cilat janë konstatimet e besueshmërisë lidhur me provat?
Rrethanat individuale dhe kontekstuale të rëndësishme të tjera:			



Hapi 2: Vlerësimi i besueshmërisë

Faktet materiale të pranuar	Faktet materiale të pasigurta	Faktet materiale të refuzuara
	↓	
	A ka ndonjë vërejtje lidhur me Nenin 4(5) QD (a, b, c, d, ose e)?	
	Vendosni pasi keni konsideruar situatën ← Pranohet Refuzohet →	

Hapi 3: Vlerësimi i rrezikut

Getting in touch with the EU

In person

All over the European Union there are hundreds of Europe Direct information centres. You can find the address of the centre nearest you at: https://europa.eu/european-union/contact_en

On the phone or by email

Europe Direct is a service that answers your questions about the European Union. You can contact this service:

- by freephone: 00 800 6 7 8 9 10 11 (certain operators may charge for these calls),
- at the following standard number: +32 22999696 or
- by email via: https://europa.eu/european-union/contact_en

Finding information about the EU

Online

Information about the European Union in all the official languages of the EU is available on the Europa website at: https://europa.eu/european-union/index_en

EU publications

You can download or order free and priced EU publications at: <https://op.europa.eu/en/publications>. Multiple copies of free publications may be obtained by contacting Europe Direct or your local information centre (see https://europa.eu/european-union/contact_en).

EU law and related documents

For access to legal information from the EU, including all EU law since 1952 in all the official language versions, go to EUR-Lex at: <http://eur-lex.europa.eu>

Open data from the EU

The EU Open Data Portal (<http://data.europa.eu/euodp/en>) provides access to datasets from the EU. Data can be downloaded and reused for free, for both commercial and non-commercial purposes.



Publications Office
of the European Union